

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR QYTETIN E TIRANËS

- Qyteti i Tiranës kufizohet në veri nga Kodër-Kamëz me lartësi 112 m mbi nivelin e detit; në jug nga Selita me lartësi 303 m mbi nivelin e detit; në perëndim nga Universiteti Bujqësor dhe në lindje nga Kodra e Surelit me lartësi 418 m mbi nivelin e detit.
- Temperatura mesatare vjetore është 16°C.
- Sasia mesatare e rreshjeve është 1,297 mm.
- Tirana përshkohet nga 2 lumenj kryesorë: Lumi i Lanës (nga Ish Autotraktorët tek Rezervati i Peshkut) me gjatësi 15.3 km dhe Lumi i Tiranës (nga shkalla e Tujanit tek Universiteti Bujqësor) me gjatësi 10.25 km.
- Në Tiranë ndodhen 4 liqene: Liqeni i Tiranës, Liqeni i Kodër-Kamëz, Liqeni i Farkës dhe Liqeni i Tufinës.

### Liqenet kryesore

Liqenet	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Lartësia mbi nivelin e detit (m)	Thellësia maksimale (m)
Liqeni i Tiranës	0.55	118	4.5
Liqeni i Kodër Kamzës	0.25	173	3.2
Liqeni i Farkës	0.55	260	
Liqeni i Tufinës	0.04	240	


Sipas Zyrës së Gjendjes Civile në Bashkinë e Tiranës, popullsia e qytetit deri në Dhjetor 2006 arrin në rreth 600,339 banorë, nga të cilët 49.7% janë meshkuj dhe 50.3% janë femra.

Krahasuar me vitin 2005 do të vinim re një rritje të popullsisë me 2.5%, numrit të lindjeve me 12.9%, numrit të vdekjeve me 13.1% si dhe numrit të martesave me 14%.


Të dhënat demografike në vite paraqiten në mënyrë më të detajuar në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Emërtimi	Popullsia banuese në fund të vitit	Të ardhur	Të larguar	Lindje	Vdekje	Nr. i Martesave
Viti 2001	478,424	25,793	5,703	5,218	2,111	3,803
Viti 2002	494,409	23,744	8,320	4,809	2,372	4,581
Viti 2003	518,143	31,168	10,617	5,339	2,713	4,227
Viti 2004	552,016	42,348	24,894	4,836	2,222	3,875
Viti 2005	585,756	71,561	42,290	5,934	2,705	4,148
Viti 2006	600,339	27,093	16,285	6,702	3,060	4,730


### Popullsia banuese në Tiranë



### Vendosjet dhe shpërnguljet e popullsisë



### Lëvizja natyrore e popullsisë në vite



### Të dhëna mbi zgjidhjet martesore në vite

Emërtimi	Gjithsej	Përfunduar
Viti 2001	856	517
Viti 2002	1,166	739

Viti 2003	1,205	752
Viti 2004	850	686
Viti 2005	988	841
Viti 2006	959	753

## Të dhëna historike

Data e themelimit të qytetit të Tiranës është viti 1614, ku nën kujdesin e Sulejman Pashë Bargjinit u krijua bërthama e parë e qytetit. Sot ajo i përgjigjet sheshit ku ndodhet monumenti “Partizani i Panjohur”. Në vitin 1789, filloi ndërtimi i “Xhamisë së Et’hem Beut” dhe në vitin 1839, ndërtimi i “Kullës së Sahatit”, që sot ndodhet në qendrën e qytetit. Më 25 nëntor 1912, dy ditë para shpalljes së pavarësisë, populli i Tiranës ngriti flamurin kombëtar.


Më 8 shkurt 1920, Qeveria e dalë nga Kongresi Kombëtar i Lushnjës, u vendos në Tiranë, e cila u bë kështu kryeqyteti i vendit. Në atë kohë, qyteti i Tiranës numëronte 17,000 banorë dhe zinte një sipërfaqe prej 3 km<sup>2</sup>. Në vitin 1930, qyteti i Tiranës kishte 25,079 banorë dhe shtrihej në 8 km<sup>2</sup>. Në vitin 1950, sipërfaqja arriti 10.6 km<sup>2</sup>; në vitin 1970 deri 31 km<sup>2</sup>. Pas viteve 1990, u vu re një “bum” urbanistik. Duke iu referuar regjistrimit të parë të popullsisë, në shtator 1923, qyteti i Tiranës numëronte 10,845 banorë. Pas shpalljes së Tiranës kryeqytet të Shqipërisë, popullsia u rrit gradualisht.

## Të dhëna arkeologjike

Mozaiku i Tiranës është i vetmi monument arkeologjik brenda territorit të qytetit të Tiranës. Në vitin 1972, gjatë punës për ndërtimin e pallateve të bllokut “Partizani” në lagjen nr. 9 të qytetit të Tiranës, u zbuluan rrënojat e një ndërtese antike, njëri nga ambientet e të cilit ishte i shtruar me mozaik. Sipas autorëve, kemi të bëjmë me një qendër fshatare të shekujve të parë pas Krishtit që në fillim të shek. III u zëvendësua me një vilë fshatare (rustica). Salla me mozaik e pajisur dhe me një absidë ishte ambjenti kryesor i saj. Autorët mendojnë edhe që në shek. V-VI vendin e vilës e zuri një bazilikë paleokristiane. Pjesa e gërmuar e monumentit u rrethua dhe u vu në mbrojtje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK). Gjatë viteve 2003-2004 punimet e sistemit të rrugëve dhe instalimeve të ndryshme të bllokut “Partizani” zbuluan pranë rrethimit të monumentit pjesë të tjera të kompleksit. Më kryesoret këtu ishin vaskat e fermentimit të mushtit të rrushit, por edhe pjesë të tjera muresh në dy pika të ndryshme. Brenda këtij kompleksi u zbuluan tre stela varresh të periudhës romake. Gërmimet e fundit përforcuan mendimin se kemi të bëjmë me një vilë fshatare, ndërkohë që nuk është gjetur asnjë e dhënë për transformimin në bazilikë paleokristiane të mbështetur nga autorët e gërmimit të parë të viteve ’70. Në mënyrë konvencionale, siti arkeologjik është emërtuar dhe njihet me emrin “Mozaiku i Tiranës”.

## STEMA E BASHKISË SË TIRANËS

Stema e Bashkisë është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 215, dt. 14.11.2000. Ka në bazë të saj stemën e Skurajve, e cila është familja që sundonte Tiranën në Mesjetë, në shekujt XIV-XV. Një nga gjurmët e gjetura nga kjo familje, në zonën rrëzë Malit të Dajtit, është Stema e Skurajve, e gjetur në një bllok guri, që sot gjendet në Muzeun Historik Kombëtar. Për qytetin e Tiranës, të lindur në vitin 1614, për të gjithë banorët e tij të dyqind vjetëve të fundit, si simbol dhe si pikë referimi ka shërbyer Kulla e Sahatit, që është monumenti më domethënës i shekujve të tij të fundit. Në stemën e qytetit përfshihet edhe një kurorë me tre kulla, e vendosur përsipër shqytit, që do të jetë një simbol i përbashkët për të gjitha stemat e qyteteve.



## KËSHILLI BASHKIAK

Këshilli Bashkiak zgjidhet për një periudhë 3-vjeçare. Mandati i këshilltarit është i vlefshëm nga koha që këshilltarët bëjnë betimin dhe e nënshkruajnë atë, deri në konstituimin e Këshillit pasardhës.

Këshilli Bashkiak i Tiranës përbëhet nga 55 këshilltarë me përkatësi partiake si më poshtë:

Partia Socialiste	27 anëtarë
Partia Demokratike	21 anëtarë
Partia Socialdemokrate	2 anëtarë
Partia Demokracia Sociale	1 anëtar
Partia Aleanca Demokratike	1 anëtar
Partia Republikane	1 anëtar
Partia Lëvizja e Legalitetit	1 anëtar
Partia Demokrate e Re	1 anëtar

Këshilli Bashkiak i Tiranës ka 14 komisione të cilat janë:

Komisioni i Financave	7 anëtarë
Komisioni Juridik	5 anëtarë
Komisioni i Ekonomisë dhe Çështjeve Sociale	5 anëtarë
Komisioni i Arsimit	5 anëtarë
Komisioni i Shëndetësisë , Veterinarisë, Mbrojtjes së Mjedisit	5 anëtarë
Komisioni i Shërbimeve Publike	5 anëtarë
Komisioni i Rregullimit të Territorit	5 anëtarë
Komisioni i Jashtëm	5 anëtarë
Komisioni i Mandatave	5 anëtarë
Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtjes civile	5 anëtarë
Komisioni i Strehimit	5 anëtarë
Komisioni i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	5 anëtarë
Komisioni i Kontrollit Financiar	5 anëtarë
Komisioni i Vlerësimit të Figurave të Shquara të Qytetit	7 anëtarë

Për vitin 2006, Këshilli Bashkiak i Tiranës ka miratuar gjithsej 78 vendime të cilat janë si më poshtë:

### Datë 30/01/2006

1. “Për miratimin e detyrës së projektimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Tiranës”
2. “Për përcaktimin e vendndodhjes së parkimeve me pagesë për shërbimin taksi (4+1, (8+1) dhe të mjeteve për transport të mallrave për të tretë në qytetin e Tiranës”

### **Datë 24/02/2006**

3. “Për trajtimin e familjeve që kanë humbur banesat nga rënia e firmave piramidale”
4. Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.7, Dt.07/03/2003 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” ndryshuar me V.K.B nr.1, dt.17/02/2005 dhe nr.57, dt.23/09/2005
5. Mbi emërtimin e Shkollës së Mesme Elektrike me emrin e Mësuesit të Popullit “Gjergj Canco”.
6. Për një ndryshim të pjesshëm në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.57, dt.09/12/2004
7. Mbi Numrin e punonjësve të njësive bashkiake të Tiranës
8. Për mbarimin para afatit të mandatit dhe dhënien e mandatit këshilltarit
9. Për një ndryshim në numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake të qytetit të Tiranës
10. Për Miratimin e rregullores administrative të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit
11. Për Miratimin e rregullores administrative Të Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit
12. Për Miratimin e rregullores administrative të Qendrës Kulturore “Tirana”
13. Mbi Miratimin në parim të zgjatjes së afatit të dhënies me qera të kontratës së objektit me sipërfaqe 500 m<sup>2</sup> të Uzinës Mekanike në administrim të Bashkisë së Tiranës
14. Për disa ndryshime në nenet 13 dhe 29 të rregullores së brendshme të funksionimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.31, dt.31/05/2004

### **Datë 27.3.2006**

15. Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2005 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2006
16. Mbi një ndryshim brenda strukturës së Qendrës Kulturore “Tirana” dhe shtesës në buxhetin e saj me qëllim riorganizmin e Ansambllit Folklorik “Tirana”
17. Për një ndryshim në numrin e punonjësve të Sektorit të Financës dhe Arkës në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore
18. Për një ndryshim në numrin e punonjësve të Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit
19. Për pajisjen me autorizim definitiv dhe privatizim të bodrumit, Ish-Lavanteri në adresën Rruga e Dibrës, P.328, Shk.1, Tiranë
20. Për trajtimin me strehim nga Enti Kombëtar i Banesave të familjeve të pastreha në situatë emergjente me Statusin e Invalidit Paraplegjik-Tetraplegjik

### **Datë 16.5.2006**

21. Për antarësimin e Bashkisë së Tiranës në Rrjetin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Qytetet e Shëndetshme në Europë (Ëho Healthy Cities Network in Europe).
22. Mbi emërtimin e Çerdheve të Qytetit të Tiranës
23. Mbi emërtim rruge të paemëtuara dhe Institucioni Kulturor në territorin e Njësive Bashkiake Nr.2, 7 dhe 10

24. Mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të pesë autobuzëve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Funerale Tiranë
25. Mbi përcaktimin e linjave të transportit qytetas të udhëtarëve, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe ripërcaktimi i stacioneve të qëndrimit të autobuzëve të shërbimit në këto linja.
26. Mbi kalimin kapital të një autoveture Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit

#### **Datë 19.6.2006**

27. Mbi miratimin e kredisë me Ministrinë e Financave dhe Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e Projekteve të Bashkisë së Tiranës.
28. Për miratimin e projektit “Për një sistem të ri parkimi për Tiranën”
29. Për miratimin e dhënies me qera të objekteve me sipërfaqe 200-500 m<sup>2</sup> të pasurive të Ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë
30. Për miratimin e dhënies me qera të objekteve me sipërfaqe mbi 500 m<sup>2</sup> të pasurive të Ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë
31. Për disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të varësisë për efekt të ndryshimit të pagës minimale në shkallë vendi
32. Për miratimin dhe financimin e pjesshëm të projektit “Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe çerdhe nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të aktorëve përgjegjës”
33. Për miratimin dhe financimin e pjesshëm të projektit “Qendër ditore komunitare për të moshuarit”
34. Për miratimin dhe financimin e pjesshëm të projektit “Të mësojmë duke vepruar”
35. Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin e juridiksionit të Bashkisë së Tiranës.
36. Për miratimin e formimit të shoqërisë anonime me kapital të përbashkët të Bashkisë së Tiranës dhe “Tirana Sport” Sh.p.k
37. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.55, dt.27.04.2001, “Për miratimin e ndërlidhësave me komunitetin në Njësitë Bashkiake të Tiranës”

#### **Datë 17.7.2006**

38. Mbi një riorganizim të strukturës së Njesisë së Planit Rregullues pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Urbanistikës në Bashkinë e Tiranës
39. Për nivelin e pagave të punonjësve në Bashkinë e Tiranës
40. Për nivelin e pagave për punonjësit e Njësive Bashkiake të Tiranës
41. Për shpërblimin e sportistëve të Klubit Sportiv “Tirana” pjesëmarrës në Lojrat Mesdhetare 2005
42. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.7, dt.7.3.2003 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Qytetin e Tiranës” ndryshuar me V.K.B nr.1, dt.17.2.2005, V.K.B nr.54, dt.23.9.2005 dhe V.K.B nr.4, dt.24.2.2006
43. Për një shtesë fondi investimesh në buxhetin e Njesisë Bashkiake Nr.10
44. Për mbarimin para afatit të mandatit dhe dhënien e mandatit këshilltarit

### **Datë 11.9.2006**

45. Për miratimin e programit 10-vjeçar të strehimit social në Tiranë
46. Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.69, dt.20.12.2005 “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës”, të truallit 460 m<sup>2</sup> pranë Ministrisë së Bujqësisë
47. Mbi miratimin dhe zbatimin e marrëveshjes për projektin “Zhvillimi i rrugëve bashkiake në qytetin e Tiranës”, financuar me kredi nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
48. Për ngritjen e strukturave administrative për zbatimin e projektit “Zhvillimi i rrugëve bashkiake në qytetin e Tiranës”, financuar me kredi nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
49. Për kalimin e kinemave “Dajti”, “Agimi” dhe “Lapraka” në varësi të Qendrës Kulturore “Tirana”. Një ndryshim në strukturën dhe buxhetin e saj, si dhe transferimin e aktiveve të qëndrueshme, qarkulluese dhe detyrimeve debitore e kreditore të administratës së kinemave, sipas bilancit të datës 31.03.2006, në Qendrën Kulturore “Tirana”
50. Për kalimin kapital të ndërtesave dhe vlerës kontabile të ndërtesave të Njësive Bashkiake, Njësive Bashkiake të Qytetit të Tiranës
51. Për kalimin kapital të ndërtesave dhe vlerës kontabile të ndërtesave të Bibliotekave Publike, Njësive Bashkiake të qytetit të Tiranës
52. Për një shtesë fondi investimesh në objektin “Rikonstruksioni i Bulevardit “Dëshmorët e Kombit”
53. Mbi detyrimet financiare të Bashkisë së Tiranës ndaj personave të tretë, që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë
54. Për heqjen nga lista e inventarit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit të sipërfaqes 2075 m<sup>2</sup> (brenda territorit të fidanishtes), si dhe reflektimi i këtij ndryshimi në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës
55. Për një ndryshim të vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.15, datë 27.3.2006 “për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2005 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2006

### **Datë 10.11.2006**

56. Për një ndryshim të planit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2006, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.15, datë 27.3.2006
57. Për transferim fondesh të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2006.
58. Mbi detyrimet financiare të Bashkisë së Tiranës ndaj personave të tretë që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë.
59. Për kalimin kapital të asetit të Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit depo dhe mur rrethues të Sektorit të D.D.D. Rruga “Muhamet Gjollështa”, pranë Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
60. Për shitjen e 5,394 m<sup>2</sup> truall të zënë me ndërtime të shoqërisë GintashAlb-Konstruksion Sh.p.k.
61. Për zhvillimin e infrastrukturës së disa parkimeve nëntokësore në qytetin e Tiranës.



62. Për krijimin e qendrave sociale “Qendër komunitare multidisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë”, qendrës “Të qëndrojmë së bashku” dhe qendrës “Qendër komunitare për të moshuarit” miratimin e strukturës organizative dhe financimin e kontributit të Bashkisë së Tiranës
63. Për ndryshimin e destinacionit të një pjese të Ndërmarrjes Metalike “Tirana” në Qendër Sociale “Shtëpia e Përbashkët” si dhe miratimin e kërkesës për transferim në pronësi të këtij objekti pranë Bashkisë së Tiranës.
64. Për miratimin e listës së pjesshme (pjesa e tretë) të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin e juridiksionit të Bashkisë së Tiranës
65. Për kërkesën e Bashkisë së Tiranës për grantet konkuruese të Ministrisë së Brendshme
66. Për emërtimin e një rruge me emrin “Papa Gjon Pali II-të”
67. Për emërtimin e rrugëve të paemërtuara në territorin e Njësisë Bashkiake Nr.2
68. Për emërtimin e rrugëve të paemërtuara në territorin e Njësisë Bashkiake Nr.4
69. Për emërtimin e një rruge me emrin “Lekë Dukagjini”
70. Për emërtimin e rrugëve të paemërtuara në territorin e Njësisë Bashkiake Nr.11
71. Për miratimin e kërkesës për transferim në pronësi të Bashkisë së Tiranës të një prone të paluajtshme shtetërore të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.69, Dt.20.12.2005 “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës” të Fonder Mek Sh.a territori i të cilave do të përdoret për ngritjen e disa banesave sociale.
72. Për transferim fondesh në buxhetin e Drejtorisë Nr.1 dhe Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit.
73. Për miratimin e listës së transferimit në pronësi të Bashkisë së Tiranës të disa pronave të paluajtshme shtetërore të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.69, Dt.20.12.2005 “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës” aktualisht në administrimin e Bashkisë së Tiranës që do të përdoren për ngritjen e banesave sociale.
74. Për financimin e pemës dekorative me rastin e Vitit të Ri 2007.
75. Për vendosjen në Tiranë të memorialit të Adem Jasharit.
76. Për sistemimin e burimit të financimit për blerjen e pajisjeve të shkollës së mesme të përgjithshme “Sandër Prosi” Sauk.
77. Për heqjen nga lista e inventarit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit të sipërfaqes 1200 m<sup>2</sup>, si dhe reflektimin e këtij ndryshimi në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të cilat janë në territorin e juridiksionit të Bashkisë së Tiranës.
78. Për miratimin e dhënies me qera të objekteve me sipërfaqe 200-500 m<sup>2</sup> të pasurive të ndërmarrjeve në administrim të Bashkisë.

## Punësimi

Sipas informacionit të marrë nga **Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**, në rrethin e Tiranës forcat aktive të punës për vitin 2006 llogariten në rreth 188,217 persona. Nga këta persona, vetëm 173,235 prej tyre numërohen të punësuar, konkretisht:

- 31% në sektorin shtetëror;
- 69% në sektorin privat;

## Papunësia

Sipas **Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**, në fund të vitit 2006, në rrethin e Tiranës rregjistrohen gjithsej 14,982 punëkërkues të papunë (PP), nga të cilët 87.8% mbështeten me të ardhura; 0.3% janë PP për herë të parë në tregun e punës dhe 11.9% PP të kategorive të tjera. Gjithashtu, rregjistrohen 9,341 PP afatgjatë dhe 309 PP që kanë filluar punë gjatë muajit. Nëse do të bënim një ndarje të tyre sipas grupmoshave, do të vinim re:

- 6% i përkasin grupmoshës 16-19 vjeç
- 14% i përkasin grupmoshës 20-24 vjeç
- 20% i përkasin grupmoshës 25-34 vjeç
- 29% i përkasin grupmoshës 35-45 vjeç
- 30% janë mbi 45 vjeç

Sipas nivelit arsimor shpërndarja e tyre është si më poshtë:

- 61% me arsim 8-vjeçar
- 17% me arsim të mesëm
- 15% me arsim profesional
- 6% me arsim të lartë

## Pensionet

Pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, deri në Dhjetor 2006 në Prefekturën e Tiranës janë të rregjistruar 95,739 pensionistë gjithsej. Nga këto:

- 82.6 % marrin pension pleqërie
- 8.6 % marrin pension familjar
- 8.7 % marrin pension invaliditeti
- 0.1 % të tjera

## Shëndetësia

Sipas informacionit të marrë nga INSTAT, në qytetin e Tiranës ushtrojnë aktivitetin e tyre këto institucione shëndetësore publike:

- 15 poliklinika
- 11 konsultore të gruas
- 12 konsultore të fëmijës

Sipas informacionit të marrë nga Ministria e Shëndetësisë gjatë vitit 2006 janë licencuar 710 subjekte private nga të cilët:

- 183 mjekë
- 16 klinika mjekësore
- 9 laboratorë mjekësor
- 14 laborantë mjekësor
- 21 grosist mjekësor
- 170 farmacistë
- 37 depo farmaceutike
- 13 ndihmës farmacist
- 155 stomatologë

- 2 ndihmës stomatolog
- 13 laborant dentar
- 3 laboratorë dentar
- 12 grosist dentar
- 3 klinika dentare
- 38 infermierë
- 1 infermier mami
- 2 laboratorë optik
- 6 laborantë optik
- 2 laborant rontgeni
- 1 kimistë
- 6 masazher
- 3 opticienë

## Arsimi

Në Qytetin e Tiranës funksionojnë 29 çerdhe, me 1,758 fëmijë, 252 edukatore 463 punonjës. Bashkia e Tiranës ofron shërbime për fëmijët dhe komunitetin nëpërmjet Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve e cila është në varësi të saj.

Gjatë viteve 1998 - 2000 Bashkia e Tiranës ka bashkëpunuar me fondacione të huaja, të cilat kanë financuar rikonstruksionin e 6 çerdheve: Çerdhes Nr. 4, 15, 45, 48, 52 dhe 54.

Gjatë viteve 2001- 2006 Bashkia e Tiranës për herë të parë ka financuar nga të ardhurat e veta për rikonstruksionin e 14 çerdheve të qytetit të Tiranës (Çerdhja Nr. 8, 10, 11, 13, 16, 24, 30, 35, 42, 47, 50, 51, Çerdhja Shkozë dhe Çerdhja Kodër-Kamëz) dhe ka bashkëpunuar me fondacione të huaja për rikonstruksionin e 6 çerdheve (Çerdhja Nr.1, 14, 17, 19, 56, Çerdhja Bregu i Lumit)

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohen të dhëna për vitin shkollor 2005-2006 në institucionet arsimore të qytetit të Tiranës:

### Të dhëna për arsimin

Viti 2005-2006

Nr.	Emërtimi	Publike	Jopublike	Gjithsej
<b>1</b>	<b>Kopshte</b>	<b>43</b>	<b>25</b>	<b>68</b>
	Fëmijë të regjistruar	6,033	923	6,956
<b>2</b>	<b>Shkolla gjithsej</b>	<b>79</b>	<b>69</b>	<b>148</b>
<b>A</b>	<b>9-vjeçare</b>	<b>55</b>	<b>40</b>	<b>95</b>
	Nx. në Shtator	47,884	5,758	53,642
	Nx. në Qershor	48,216	5,890	54,106
<b>B</b>	<b>Shkolla të mesme</b>	<b>24</b>	<b>29</b>	<b>53</b>
	Nx. në Shtator	22,984	4,410	27,394
	Nx. në Qershor	21,927	4,564	26,491
<b>B.1</b>	<b>Të përgjithshme</b>	<b>15</b>	<b>22</b>	<b>37</b>
	Nx. në Shtator	17,527	2,751	20,278
	Nx. në Qershor	16,605	2,923	19,528

<b>B.2</b>	<b>Profesionale</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>16</b>
	Nx. në Shtator	5,457	1,659	7,116
	Nx. në Qershor	5,322	1,641	6,963

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës

### Studentë të regjistruar me kohë të plotë

Viti 2005-2006

Emërtimi	Të regjistruar		Pranuar të rinj	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
<b>I. Arsimi publik</b>	<b>28,210</b>	<b>15,259</b>	<b>5,613</b>	<b>2,669</b>
Universiteti i Tiranës	16,771	11,651	2,556	1,713
Universiteti i Politeknik	5,368	1,408	1,303	344
Universiteti Bujqësor	4,684	1,719	1,385	482
Akademia e Arteve	859	381	244	106
Instituti i Fiskulturës	528	100	125	24
<b>II. Arsimi jopublik</b>	<b>1,716</b>	<b>951</b>	<b>772</b>	<b>417</b>
UFO Dental	365	169	236	118
Zonja e Këshillit të mirë	428	244	230	142
Luarasi	496	315	160	86
New York	403	213	122	61
Marin Barleti	24	10	24	10
<b>Gjithsej (I+II)</b>	<b>29,926</b>	<b>16,210</b>	<b>6,385</b>	<b>3,086</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës

### Studentë të regjistruar pa shkëputje nga puna

Viti 2005-2006

Emërtimi	Korrespondenca		Me kohë të pjesshme		Edukim në distancë	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Universiteti i Tiranës	3,489	1,614	3,929	2,504	-	-
Universiteti i Politeknik	-	-	-	-	566	144
Universiteti Bujqësor	336	104	1,468	521	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>3,825</b>	<b>1,718</b>	<b>5,397</b>	<b>3,025</b>	<b>566</b>	<b>144</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës

## Kultura dhe sporti

Gjatë viteve 2001-2006 Bashkia e Tiranës ka organizuar dhe mbështetur rreth 200 evenimente kulturore dhe sportive. Rreth 100 shoqata kulturore dhe 25 individë të shquar të fushës së sportit dhe kulturës kanë bashkëpunuar me Bashkinë e Tiranës për realizimin e tyre. Çdo vit, në kuadër të festave kombëtare dhe ndërkombëtare, Bashkia e Tiranës organizon aktivitete kulturore, duke ndezur gjatë gjithë vitit jetën artistike të kryeqytetit.

Ndër projektet rinore mund të përmendim:

- Rinfest aktiviteti i cili përfshin këngë, kërcim, recitim etj.
- Alterfest i cili sjell rryma të reja alternative në fushën e muzikës dhe kërcimit.

- Akademia Verore e cila ndihmon në nxitjen e talenteve të reja në fushën e arteve figurative.

Gjatë vitit 2006, nga **Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** janë realizuar projektet e mëposhtme:

### **Projekte Kulturore:**

Dita e Verës	Pezë on the Rock
Opera "Një jetë në stuh"i	Akademia Verore e Pikturës
Koncert i Goran Bregoviç në Tiranë	Ditari
Shpëtim Kushta në 60 vjetorin e lindjes	Mënyrat e Zonjushës Margaritë
Rinfest 2006	Alter Fest Muzikë
Festivali i krijuesve të rinj	Nderim, respekt dhe vlerësim për ata që i dhanë
Show Muzikor	shpirtin dhe jetën artit shqiptar ndër vite
"Pak qetësi. Le të dëgjojmë muzikë..."	Retrospektivë 2006
"Etera Tondo"	Panairi i librit "Tirana 2006"
Këngët e Tokës	Dita Europiane e Violinës
Mozart për të gjithë	T'u shërbejë të varfërve të më të varfërve të
Tirana Jazz Festival	gjakut tim
Dita e nënës	Kënga Magjike 2006
Poezia e Tingujve	Të pathënat e një ylli
Marrja e titullit Prof.Dr. e poetit Lasgush	Qypi Magjik
Poradeci	Tirana Internacional Film Festival
Festivali i teatrove të shkollave të mesme	Ditët e Muzikës së re Shqiptare
Në kërkim të videoartit	Krishlindjet po afrojnë
Mos hesht	Art Alternativë
Dita Ndërkombëtare e Muzikës	Nata e Bardhë
	Gëzuar Tiranë

### **Aktivitete Sportive:**

Kampionati Kombëtar i Gjinnastikës Aerobike  
 Turne lojrash me nxënësit me aftësi të kufizuar  
 Fillim i mbarë  
 Kombinati, Laprakë e Sauku janë Tiranë  
 Kampionati i ping-pongut

Gjatë periudhës 2001-2006 nga Bashkia e Tiranës janë rikonstruktuar 12 momumente kulture dhe buste si dhe janë vendosur 6 buste dhe monumete të reja dedikuar figurave të shquara të kombit shqiptar si Nënë Tereza, Adem Jashari etj.

Ndër monumentet e kulturore të rrethit të Tiranës përmendim

- Kalaja e Tiranës, bërthama historike e kryeqytetit
- Kisha e Kroit të Shëngjinit
- Kalaja e Prezës

- Kalaja e Petrelës
- Xhamia e Tiranës
- Qendra e Tiranës, Ansambël Monumental
- Ura e Tabakëve
- Varri i Kapllan Pashës në Tiranë
- Kulla e Sahatit

Në Tiranë ka gjithsej:

- 8 biblioteka një prej të cilave është Biblioteka Kombëtare
- 1 Muze Historik Kombëtar i vizituar nga 47,926 persona gjatë vitit 2006
- 5 Shtëpi muze dhe 56 monumente kulture
- 2 stadione futbollit të cilat i përkasin Klubit Futboll Tirana
- 2 stadione lojrash me dorë të cilat i përkasin Klubit Shumësporte Tirana
- 6 terrene sportive (4 prej tyre i përkasin Klubit Shumësporte Partizani, 1 Klubit Shumësporte Dinamo dhe 1 Klubit Sportiv Tirana)
- 4 fusha futbollit (të cilat i përkasin 2 Klubit Futboll Tirana dhe 2 Klubit Sportiv Futboll Dinamo)
- 1 pishinë e cila i përket Klubit Shumësporte Partizani
- 2 poligone qitjeje (1 Klubit Sportiv Tirana dhe 1 Klubit Studenti)
- 11 palestra (8 prej tyre i përkasin Klubit Shumësporte Partizani, 2 Klubit Sportiv Tirana, 1 Klubit Studenti)
- 1 sallë shahu, ping-pongu, etj. (e cila i përket Klubit Shumësporte Partizani)

Në Tiranë zhvillojnë aktivitete kulturore një sërë institucionesh si: Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, Teatri Kombëtar, Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore, Qendra Kulturore Tirana, Teatri Kombëtar për Fëmijë, Kinema Millenium, Galeria Kombëtare e Arteve.

Për vitin 2006, aktiviteti i institucioneve kulturore është si më poshtë:

*Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit* ka vënë në skenë 5 premiera dhe 133 shfaqje, të ndjekura nga 32,500 spektatorë. Të ardhurat e grumbulluara gjithsej janë 13,227 mijë lekë.

*Teatri Kombëtar* ka vënë në skenë 3 premiera dhe 85 shfaqje të ndjekura nga 9,133 spektatorë. Të ardhurat e grumbulluara gjithsej janë 2,364 mijë lekë.

*Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore* ka vënë në skenë 1 premierë dhe 53 shfaqje, të ndjekura nga 40,000 spektatorë. Të ardhurat e grumbulluara gjithsej janë 352 mijë lekë.

*Teatri Kombëtar për Fëmijë* ka vënë në skenë 3 premiera dhe 134 shfaqje të ndjekura nga 10,328 spektatorë. Të ardhurat e grumbulluara gjithsej janë 2,716 mijë lekë.

*Kinema Millenium* ka dhënë 24 premiera dhe 1,808 shfaqje. Të ndjekura nga 80,173 spektatorë. Të ardhurat e grumbulluara gjithsej janë 50,969 mijë lekë.

*Qendra Kulturore Tirana* ka dhënë 82 shfaqje të ndjekura nga 10,555 spektatorë dhe të ardhurat e grumbulluara kanë qenë 2,245 mijë lekë.

*Galeria Kombëtare e Arteve* ka çelur 34 ekspozita (27 të autorëve vendas, 6 të autorëve të huaj dhe 1 me autorë të përbashkët) në të cilat janë ekspozuar 419 vepra (383 vepra të autorëve vendas dhe 36 vepra të autorëve të huaj). Këto ekspozita janë ndjekur nga 6,340 vizitorë dhe të ardhurat e grumbulluara kanë qenë 312 mijë lekë

Në tabelën e mëposhtme paraqitet aktiviteti i bibliotekave të lagjeve dhe Bibliotekës Kombëtare:

#### Aktiviteti i Bibliotekave

Viti 2006

Nr.	Emërtimi	Gjithsej	Biblioteka Kombëtare
1	Biblioteka	8	1
2	Tituj të hyrë gjatë vitit	4,580	3,931
3	Libra të hyra	14,537	13,612
4	Libra të dhëna për lexim	117,953	103,958
5	Libra në fond	1,068,626	991,637
6	Lexues	12,032	10,580
7	Numri i frekuentuesve në sallë	97,379	89,154

Burimi: Biblioteka Kombëtare dhe Administrata e Bibliotekave

## SHËRBIMET SOCIALE

Gjatë vitit 2006, nga **Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore** është punuar shumë në drejtim të integritit të grupeve të marxhinalizuara, rritjes së kujdesit për fëmijët në nevojë, integrimi i moshës së tretë dhe mbështetja e tyre në aktivitete dhe projekte, vullnetarizmit jo fitimprurës, përmirësimit të infrastrukturës parashkollore dhe parauniversitare si dhe hartimit të planit 10 vjeçar të strehimit.

Projektet dhe aktivitetet e kësaj Drejtorie të zhvilluara gjatë vitit 2006 paraqiten si më poshtë:

### Projekte sociale të miratuara në Këshill Bashkiak

1. Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte dhe çerdhe nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të aktorëve përgjegjës - bashkëpunim me shoqatën Every Child me fond 1,701 mijë lekë
2. Qendër Ditore Komunitare për të Moshuarit - bashkëpunim me Kryqin e kuq Shqiptar, Dega Tiranë me fond 683 mijë lekë
3. Krijimi i 3 Qendrave Sociale në kuadër të projekteve të bankës Botërore:
  - Qendra komunitare multidisiplinare për fëmijët dhe familjet në nevojë
  - Të qëndrojmë së bashku
  - Qendër komunitare për të moshuarit

## Projekte të Bankës Botërore

1. Qendër multidisiplinare komunitare për fëmijë dhe familjen – bashkëpunim me shoqatat “EveryChild” dhe “Qendra Kombinat” (projekt në vazhdim)
2. Shtëpia e Përbashkët – bashkëpunim me shoqatën “Shpresë dhe Dashuri”
3. Mos Vuaj në Heshtje! - bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare e Trajtimit të Dhimbjes
4. Qendra Komunitare Social Kulturore Rinore – bashkëpunim me shoqatën “FORIS”
5. Porta parandaluese HIV / AIDS - bashkëpunim me shoqatën “APRAD”

## Projekte të tjera

1. Së bashku për një familje dhe shoqëri pa dhunë
2. Shërbime Sociale për Fëmijët në rrugë në qytetin e Tiranës
3. Monitorimi i punës së fëmijëve
4. Të mësojmë duke vepruar
5. Dhënie stimuli nxënësve me rezultate të shkëlqyera në shkollat publike të qytetit të Tiranës  
Nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin mësimor 2005-2006 kanë përfituar:
  - 825 nxënës të shkollave 9-vjeçare
  - 640 nxënës të shkollave të mesme
6. Ulje e tarifave të pagesës për ushqimin e fëmijëve në kopshte dhe çerdhe.  
Gjatë vitit 2006 kanë përfituar si më poshtë:
  - 125 fëmijë në çerdhe, me 50% reduktim të detyrimit mujor.
  - 86 fëmijë në kopshte, me 50 % reduktim të detyrimit mujor.
  - 50 fëmijë në çerdhe, me 100% reduktim të detyrimit mujor.
  - 70 fëmijë në kopshte, me 100% reduktim të detyrimit mujor.
7. Rehabilitim i çerdheve Nr.8, 10 dhe 3
8. Projekte me karakter investimi në pajisje për shkollat periferike  
Nga fondet e “Grantit Japonez”, është mundësuar pajisja e shkollës “Mustafa Greblleshi”  
Me fonde të të ardhurave të Bashkisë së Tiranës është mundësuar pajisja me orendi e shkollës së mesme “S. Prosi”, Sauk.
9. Senati i Fëmijëve në nivel lokal është strukturë e përbashkët e Bashkisë së Tiranës dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale – Tiranë me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë për të drejtat e fëmijëve.
10. Projekti “Kampi i Miqësisë” është organizuar nga Bashkia e Tiranës dhe Shoqata për Mbështetjen Sociale të Rinisë (ARSIS).

## Aktivitete të tjera

- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve
- Dita e Dhurimit të Gjakut
- Inagurimi i Qendrës së Zhvillimit “Pëllumbat”
- Dita ndërkombëtare e të moshuarve
- Dita Universale e Fëmijëve
- Dita e Vullnetarizmit



- Festa e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri

### Ndihma ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar

Në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm jepet ecuria e fondit të përdorur për persona me aftësi të kufizuar ndër vite, si dhe e fondit të ndihmës ekonomike:

#### Fondi i përdorur për persona me aftësi të kufizuar

000/lekë

Emërtimi	Të paaftë		Kujdestarë		Fondi gjithsej
	Numri	Vlera	Numri	Vlera	
Viti 2001	2,725	169,220	349	22,051	191,271
Viti 2002	2,987	211,939	402	26,514	238,453
Viti 2003	3,245	248,228	448	32,182	280,410
Viti 2004	3,529	289,433	508	38,945	328,378
Viti 2005	3,849	320,824	548	42,260	363,084
Viti 2006	4,356	396,435	653	60,509	456,944

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore pranë Bashkisë Tiranë

Fondi për persona me aftësi të kufizuar gjatë vitit 2006 ka pësuar një rritje prej 139% në krahasim me vitin 2001 dhe 26% në krahasim me vitin 2005.

#### Familje që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe fondi gjithsej

000/lekë

Emërtimi	Ndihmë e pjesëshme		Ndihmë e plotë		Gjithsej	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Viti 2001	85	3,410	6,895	279,390	6,980	282,800
Viti 2002	106	4,401	6,802	264,471	6,908	268,872
Viti 2003	127	5,406	6,369	254,305	6,496	259,711
Viti 2004	161	6,847	6,307	250,089	6,468	256,936
Viti 2005	169	6,053	5,885	175,338	6,054	181,391
Viti 2006	153	4,849	5,322	165,916	5,475	170,765

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore pranë Bashkisë Tiranë

## AKTIVITETI EKONOMIK

Buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2006 është produkt i zbatimit të politikave të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak, në sistemin fiskal dhe atë të menaxhimit të shpenzimeve për t'i ofruar komunitetit shërbime në standarte sa më të mira.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.15 dt.27.03.2006, “Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2005 dhe detajimin e buxhetit të vitit 2006”, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.55 dt.11.09.2006, “Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.15 dt.27.03.2006”, Bashkia e Tiranës për vitin 2006 arriti të administrojë një fond prej 6,750,104 mijë lekësh kundrejt fondit të planifikuar prej 7,679,762 mijë lekësh.

### I. ANALIZA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës përfshijnë të ardhurat e veta nga Taksat dhe Tarifat Vendore dhe të ardhurat nga Buxheti i Shtetit si fondet e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara.

**Të ardhurat vendore** duke përfshirë dhe fondin e mbartur në fund të vitit 2006, arritën shumën 4,142,808.7 mijë lekë.

#### Realizimi i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës


*Viti 2006*

Nr	Emërtimi	Parashikimi (000/lekë)	Realizimi (000/lekë)	%
<b>I</b>	<b>Të ardhurat të taksueshme (1+2+...+9)</b>	<b>2,978,655.0</b>	<b>2,601,177.6</b>	<b>87.3</b>
1	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	425,000.0	349,688.8	<b>82.3</b>
2	Taksa mbi biznesin e vogël	849,106.0	943,725.0	<b>111.1</b>
3	Taksa për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve	160,600.0	146,454.7	<b>91.2</b>
4	Taksa për zënieën e hapësirave publike	186,210.0	156,806.5	<b>84.2</b>
5	Taksa e fjetjes në hotel	52,000.0	55,053.1	<b>105.9</b>
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,000,000.0	716,060.8	<b>71.6</b>
7	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pas. e paluajt.	150,000.0	105,949.0	<b>70.6</b>
8	Taksa për tabelën	26,000.0	26,677.6	<b>102.6</b>
9	Taksa e gjelbërt	129,739.0	100,762.1	<b>77.7</b>
<b>II</b>	<b>Të ardhura jo tatimore (1+2+3)</b>	<b>633,985.0</b>	<b>543,347.8</b>	<b>85.7</b>
1	Tarifat	510,485.0	427,389.0	83.7
2	Të ardhura të tjera	30,000.0	24,309.8	81.0
3	Pagesa	93,500.0	91,648.9	98.0
<b>III</b>	<b>Kontribute dhe sponsorizime</b>	-	-	
<b>IV</b>	<b>Gjobat</b>	<b>30,000.0</b>	<b>22,428.3</b>	<b>74.8</b>
	<b>Gjithsej</b>	<b>3,642,640.0</b>	<b>3,166,953.8</b>	<b>86.9</b>
	<b>Fondi i mbartur nga viti 2005</b>	<b>975,855.0</b>	<b>975,855.0</b>	<b>100.0</b>
	<b>Të ardhurat gjithsej</b>	<b>4,618,495.0</b>	<b>4,142,808.7</b>	<b>89.7</b>

Në mënyrë tabelare e grafike, ë ardhurave për periudhën 2001-2006 jepet si më poshtë:

### Të ardhurat në vite

Emërtimi	Plani	Realizimi	%
Viti 2001	970,000	998,132	103
Viti 2002	1,400,000	1,411,301	101
Viti 2003	2,947,190	3,666,953	124
Viti 2004	4,698,572	5,012,784	107
Viti 2005	6,259,949	5,897,644	94
Viti 2006	4,618,495	4,142,809	90



**Të ardhurat nga Buxheti i Shtetit** për Bashkinë e Tiranës gjatë vitit 2006 kapën shifrën 3,021,724 mijë lekë, nga ku:

- Të ardhurat nga fondet e pakushtëzuara (granti) 464,686 mijë lekë
- Të ardhurat nga fondet e kushtëzuara 2,557,038 mijë lekë

## II. ANALIZA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet e realizuara për vitin 2006 kapin shifrën 6,750,104 mijë lekë, nga të cilat:


- Shpenzime korrente 4,910,816 mijë lekë
- Shpenzime kapitale (Investime Publike) 1,839,288 mijë lekë

Në mënyrë të përmbledhur realizimi i buxhetit të Bashkisë në vite jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

### Realizimi i buxhetit të Bashkisë në vite

000/lekë

Emërtimi	Buxheti i Shtetit			Të ardhurat		
	Shpenzime	Investime	Gjithsej	Shpenzime	Investime	Gjithsej
Viti 2001	2,155,511	904,920	3,060,431	360,407	426,806	787,213
Viti 2002	2,186,867	589,361	2,776,228	458,162	317,424	775,586
Viti 2003	1,518,526	206,320	1,724,846	1,480,587	1,020,184	2,500,771
Viti 2004	2,507,006	671,960	3,178,966	1,817,296	1,515,224	3,332,520
Viti 2005	2,532,527	607,657	3,140,184	1,927,013	3,205,790	5,132,803
Viti 2006	2,837,868	79,300	2,917,168	2,072,948	1,759,988	3,832,936



**Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore** është struktura përgjegjëse për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore të përcaktuara në ligjet dhe vendimet e Këshillit Bashkiak si dhe ndjek marrëdhëniet me Agjentët Tatimorë për taksat dhe tarifatat vendore.

Sipas të dhënave të regjistrimit vendor të DPTTV deri në Dhjetor 2006, në qytetin e Tiranës ushtrojnë aktivitetin e tyre 19,127 njësi tregtare të cilat kategorizohen si më poshtë:

Viti 2006	
Emërtimi	Numri
Njësi tregtare aktive	18,323
Subjekte që ushtrojnë veprimtari si taksi	450
Subjekte ambulante	354
<b>Gjithsej</b>	<b>19,127</b>

Gjatë vitit 2006 kanë paguar detyrimet vendore pranë DPTTV 15,033 subjekte tregtare (1,660 subjekte më shumë se në vitin 2005) dhe 16,595 njësi (1,237 njësi më shumë se në vitin 2005) biznesi i vogël, biznesi i madh, kategori VIP dhe të tjera. Në tabelën e mëposhtme jepen likuidimet në vite sipas subjekteve:

Nr	Lloji i biznesit	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006
1	Biznesi i vogël	8,322	9,835	11,042	12,147
2	Biznesi i madh	1,780	2,071	2,084	2,275
3	Kategori VIP	142	252	242	217
4	Të tjerë	59	206	318	394
	<b>Biznese gjithsej</b>	<b>10,303</b>	<b>12,364</b>	<b>13,686</b>	<b>15,033</b>

Pranë DPTTV arkëtohen gjobat e vendosura nga strukturat e Bashkisë si Drejtoria e Kontrollit mbi Territorin, Policia Bashkiake, Drejtoria e Higjenës etj. Këto gjoba vendosen në rastet e:

- mos pagimit në kohë të detyrimeve fiskale,
- ndërtimeve pa leje në hapësirat publike,
- çarjeve pa leje të rrugëve,
- ndotjeve të mjedisit,
- krijimit të zhurmave pranë ambjenteve të banimit etj.

Gjatë vitit 2006 nga DPTTV janë vendosur 4,839 gjoba (1,143 gjoba më shumë se në vitin 2005) për të gjithë subjektet tregtarë që nuk kanë respektuar afatin e caktuar në ligj për pagimin e taksave.


Kjo Drejtori në bashkëpunim me Njësinë e Zhvillimit Ekonomik pranë Bashkisë së Tiranës, kanë kryer një studim mbi shtrirjen e bizneseve në qytetin e Tiranës.

Sipas këtij studimi, deri në muajin Mars 2006 ushtrojnë aktivitetin e tyre 16,879 biznese të ndara në:

<b>Tregti me Pakicë</b>	<b>7,898</b>
• Peshk	21
• Bulmet	92
• Mish	171
• Fruta – Perime	321
• Ushqimore	2,247
• Artikuj industriale	5,046
<b>Kohë e lirë</b>	<b>3,218</b>
• Ekspozita, Panairë	7
• Diskoteka	23
• Lojra fëmijësh	76
• Bilardo	139
• Lojra fati	146
• Institucione kulturore sportive	193
• Bar restorant	269
• Llotari sportive	279
• Bar kafe	2,086
<b>Shërbim</b>	<b>1,956</b>
<b>Artizanale</b>	<b>1,480</b>
<b>Prodhim</b>	<b>891</b>
• Prodhim dhe përpunim i lëndëve ushqimore	28
• Prodhim dhe montim mekanik, elektrik, elektronik	15
• Prodhim dhe tregtim i materialeve të ndërtimit	42
• Përpunim druri	82
• Prodhim mobiljesh	12

• Prodhime dhe përp kimike, letre, ambalazh, plastike	54
• Prodhim dhe montim kompjuterash	21
• Punim me fazon (tekstil, këpucë)	34
• Njësi prodhimi buke	603
<b>Zyra</b>	<b>623</b>
<b>Të tjera</b>	<b>327</b>
• Magazina	57
• Tregjet e shumicës	5
• Shtypshkronja	54
• Ndërtim	139
• Hotele	72
<b>Ambulantë</b>	<b>282</b>
<b>Dyqane Shumice</b>	<b>204</b>

Llojet e bizneseve



Nëse do të bënim një krahasim të numrit të bizneseve me një vit më parë do të kishim:

**A) Rritje:**

- Tregtia me pakicë me 2,704 subjekte
- Artizanale me 1,446 subjekte
- Koha e lirë me 682 subjekte
- Dyqane shumice me 204 subjekte
- Zyrat me 167 subjekte

**B) Ulje:**

- Shërbimet me 3,100 subjekte
- Ambulante me 112 subjekte
- Prodhimi me 56 subjekte
- Të tjera me 68 subjekte

Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se kemi një rritje të numrit të bizneseve me 1,768 subjekte të reja ose 11.7% në krahasim me një vit më parë.

**Njësia e Zhvillimit Ekonomik** është konceptuar si një njësi kërkimore dhe studimore aktive në marketimin ekonomik të qytetit dhe si një hallkë shumë e rëndësishme lidhëse ndërmjet administratës dhe biznesit. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2006, kjo njësi ka realizuar:

1. **Botimin “Guida e investitorëve”** e publikuar në dy gjuhë shqip dhe anglisht e cila marketon qytetin si vendndodhje për biznes dhe investime duke iu ardhur në ndihmë biznesmenëve të huaj dhe vendas.
2. **Hartën turistike të Tiranës** e cila përmban informacion për linjat e autobusëve, automateve të bankave si dhe pamje tredimensionale të disa prej objekteve kryesore të qytetit.
3. **Prodhimin e souvenireve të Tiranës** si bluza, çanta, filxhanë etj. mbi të cilat paraqiten pamjet më sinjifikative të qytetit. Qëllimi i prodhimit të këtyre souvenireve është krijimi i një imazhi të veçantë të qytetit të Tiranës si një destinacion turistik. Këto souvenire mund të përdoren për tu shitur ose për tu shpërndarë nga Bashkia si dhurata simbolike në raste vizitash të ndërsjella.
4. **Konkursin e essës më të mirë me shkollat e mesme të Tiranës mbi vlerat e qytetit** i organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore synonte të grumbullonte mendimet e të rinjve mbi karakteristikat dhe veçoritë e Tiranës.
5. **Studimin mbi shpërndarjen e llojeve të biznesit në qytetin e Tiranës** i cili shërben si një orientim fillestar për të gjithë ata biznesmenë që kanë në plan për të hapur një biznes të ri në qytetin e Tiranës.
6. **Studimin mbi asetet në territorin e qytetit**, i realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Aseteve i cili ndihmon në përcaktimin e zonave industriale të qytetit.

Gjithashtu, gjatë këtij viti kjo Njësi ka marrë pjesë në:

- Panairin e Imobiliareve në Mynih
- Konferencën Ekonomike Shqiptaro-Gjermane në Frankfurt

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2006 nga **Drejtoria e Administrimit të Aseteve** është ndjekur dhe realizuar:

- Administrimi dhe menaxhimi i ndërmarrjeve që me Vendim të Këshillit të Ministrave kanë kaluar në administrim të Bashkisë si përfaqësues i pronarit;
- Saktësimi i asetëve të Bashkisë nëpërmjet krijimit të dosjeve të inventarit të pronës në administrim të Bashkisë;
- Menaxhimi dhe monitorimi i qiradhënies së pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve.
- Përfundimi i Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtëshme të ndodhura në territorin e Bashkisë së Tiranës.
- Plotësimi me dokumentacion ligjor (genplan planimetri) të nevojshëm për regjistrimin e një prone për pronat në administrim të Bashkisë së Tiranës.
- Kryerja e Ankimimeve Administrative të Vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të dhëna në kundërshtim me ligjin në territoret e pronave në administrim të Bashkisë së Tiranës.

Gjatë vitit 2006, pranë **Drejtorisë së Dhënies së Lejeve për Ushtrim Aktiviteti** kanë aplikuar 2,286 subjekte të cilët kanë kërkuar nga Bashkia e Tiranës shërbime të ndryshme. Konkretisht:

- 47 subjekte për leje ushtrim aktiviteti

- 927 subjekte për taxi dhe kolaudim
- 1,120 subjekte për transporte të tjera
- 31 autorizim karburanti
- 161 subjekte për plotësim dokumentacioni

Të ardhurat e grumbulluara nga kjo drejtori për vitin 2006 janë 7,834.133 mijë lekë.  
Më poshtë po japim disa të dhëna për lejet në vite:

#### Të dhëna për lejet për ushtrim aktiviteti

000/lekë

Emërtimi	Leje ushtrim aktiviteti		Subjekte të licensuara në transport		Gjithsej	
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr.	Vlera
Viti 2001	84	582.7	1,597	7,099.6	1,681	7,682.3
Viti 2002	96	720.0	1,662	8,421.1	1,758	9,141.1
Viti 2003	56	498.1	2,443	8,334.7	2,499	8,832.8
Viti 2004	75	813.0	2,406	8,360.0	2,481	9,172.9
Viti 2005	52	607.2	2,309	7,594.6	2,361	8,201.8
Viti 2006	65	685.5	2,173	7,148.6	2,238	7,834.1

## Transporti

Transporti urban në qytetin e Tiranës kryhet nga pesë operatorë:

**Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve** i cili përfshin linjën:

- Kombinat–Kinostudio (gjatësia e linjës 8.7 km dhe me 24 autobuza në përdorim);

**Alb Trans** i cili përfshin linjat:

- Stacioni i trenit–Tirana e Re–Unaza e Re (gjatësia e linjës 5.8 km dhe me 14 autobuza në përdorim);
- Tufina (gjatësia e linjës 6 km dhe me 10 autobuza në përdorim);

**Ferlut** i cili përfshin linjën:

- Unaza (gjatësia e linjës 7.4 km dhe me 32 autobuza në përdorim);

**Tirana Urban Trans sh.p.k** i cili përfshin linjat:

- Qendër–Porcelan (gjatësia e linjës 3 km dhe me 9 autobuza në përdorim);
- Qendër–Uzinë Autotraktorë (gjatësia e linjës 8 km dhe me 10 autobuza në përdorim);
- Qendër–Sauk (gjatësia e linjës 8 km dhe me 12 autobuza në përdorim);

**Tirana Lines sh.p.k** i cili përfshin linjat:

- Qendër–Laprakë (gjatësia e linjës 3.2 km dhe me 7 autobuza në përdorim);
- Qendër–Kamëz (gjatësia e linjës 9 km dhe me 23 autobuza në përdorim);

Oraret e autobusëve për çdo ditë të javës janë si më poshtë:

- Në dimër 5<sup>30</sup>-23<sup>00</sup>
- Në verë 5<sup>00</sup>-24<sup>00</sup>

Ndërsa frekuenca e autobusëve është çdo 2 minuta për Unazën dhe linjën Kombinat-Kinostudio dhe çdo 3 minuta për të gjitha linjat e tjera.



## Sinjalistika

Para vitit 2000, në qytetin e Tiranës mungonte pothuajse plotësisht sinjalistika e domosdoshme e cila garantonte sigurinë në rrugë. Ekzistonin vetëm pak semaforë të tipit manual të vendosur në vitin 1992 dhe 1993. Në vitin 2000 ishin vendosur pjesërisht 5 aparatura të tjera semaforike, të cilat nuk kishin programimin e përshtatshëm në funksion të flukseve të trafikut dhe sigurisë së kalimit të këmbësorëve.

Aparaturat bashkëkohore semaforike të vendosura nga Drejtoria e Transportit në vite paraqiten si më poshtë:


- Viti 2003 20 aparatura semaforike,
- Viti 2004 23 aparatura semaforike
- Viti 2005 11 aparaturara semaforike.
- Në vitin 2006 e në vazhdim është në proces studimi për ngritjen e “Qendrës së Menaxhimit dhe Kontrollit të Trafikut” financuar nga EBRD.

Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me konsulentë të huaj kanë hartuar projektin “Një sistem parkimi për Tiranën (M-parking +)”, projekt ky që do të ndikojë në:

- Përmirësimin e transportit në përgjithësi
- Menaxhimin e mirë të lëvizjes në qytetin e Tiranës
- Qarkullimin e shpejtë
- Reduktimin e lëvizjeve pa kriter
- Lehtësimin e trafikut të zonave qendrore me aktivitet të dendur publik dhe tregtar


Deri në Dhjetor të vitit 2006 pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Dega Tiranë** janë regjistruar 12,452 mjete, të cilat paraqiten të ndarë sipas formës, markës dhe vitit të prodhimit në grafikët e mëposhtëm:

Sipas formës së mjeteve




*Shënim: Në kategorinë kamion përfshihen dhe tërheqes rrugor, A.P.V., A.T.P. dhe A.T.V. Në kategorinë të tjerë përfshihen dhe makinat teknologjike.*

### Sipas markës



### Sipas vitit të prodhimit



### Transporti ajror ndërkombëtar

Viti 2006

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjithsej	Të përbashkëta	Të huaja
1	Shoqëri ajrore	Nr	16	4	12
2	Avionë nga këto:	Nr	117,028	6,104	110,924
	Të ulur e të ngritur	Nr	16,152	6,104	10,048
	Mbikalime	Nr	100,876	0	100,876
3	Pasagjerë gjithsej	Nr	906,103	325,083	581,020
	Të hyrë	Nr	441,874	156,322	285,552
	Të dalë	Nr	464,229	168,761	295,468
4	Mallra gjithsej	Ton	2,109,035	283,728	1,825,307
	Të hyrë	Ton	1,666,952	216,557	1,450,395
	Të dalë	Ton	442,083	67,171	374,912
5	Posta gjithsej	Ton	356,842	1,973	354,869
	Të hyrë	Ton	281,683	1,973	279,710
	Të dalë	Ton	75,159	0	75,159

Burimi: INSTAT

### Transporti i mallrave dhe pasagjereve

Emërtimi	Njësia matëse	Viti 2006
<b>Transporti rrugor</b>		
Transporti i pasagjerëve	mijë pasagjerë	8,413
Transporti i pasagjerëve	mijë pasagjerë- km	48,799
<b>Transporti hekurudhor</b>		
Mallra të transportuara	mijë tonë	0.4
Mallra të transportuara	mijë tonë km	57
Transporti i pasagjerëve	mijë pasagjerë	236
Transporti i pasagjerëve	mijë pasagjerë- km	11,011

Burimi: INSTAT

Tabelat e mëposhtme japin të dhëna për kriminalitetin dhe aksidentet e ndodhura në Qarkun e Tiranës gjatë vitit 2006:

#### Të dhëna për kriminalitetin

Viti 2006

Emërtimi	Evidentuar	Zbuluar
Krime kundër personit	1,007	973
Vrasje	102	95
Krime seksuale	26	25
Të tjera	879	853
Krime kundër pasurisë	1,466	748
Vjedhje firmash prodhuese, lokale tregtie, banesash	467	253
Vjedhje automjetesh	356	71
Vjedhje të ndryshme	441	271
Mashtrime	30	28
Dëmtime të pronës	172	125
Krimi i organizuar	684	
Trafik dhe shpërndarje e lëndëve narkotike	98	
Krime ekonomiko-financiare	438	
Trafiqe të paligjshme	148	

Burimi: Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë

#### Të dhëna për aksidentet rrugore

Viti 2006

Emërtimi	Numri
Aksidente gjithsej	270
Nr i personave të aksidentuar	330
Të vrarë	45
Të plagosur	285

Burimi: INSTAT

Në tabelat e mëposhtme paraqiten tarifat e bisedimeve telefonike lokale si dhe të shërbimeve telefonike që ofron filiali i **Albtelecom Tiranë**:

#### Tarifat e bisedimeve telefonike lokale

Viti 2006

Kategoria e abonentit	Tarifë e zakonshme (lekë)		Tarifë e reduktuar (lekë)	
	Për 2 min e para	Çdo 2 min të tjera	Për 3 min e para	Çdo 3 min të tjera
Abonentë familjarë	3.0	1.0	2.0	1.0
Abonentë të tjerë	4.5	1.5	3.0	1.5

Shënim: Tarifa e zakonshme përfshin periudhën kohore 08.00-20.00 për ditët e hëna deri të premten. Tarifa e reduktuar përfshin periudhën kohore 20.00-08.00 për ditët e hëna deri të premten dhe 24 orë për të shtunën, të dielën dhe festa zyrtare.

## Tarifat e shërbimeve telefonike në filialin Albtelecom Tiranë

Viti 2006

Kategoria e abonentit	Çmimi i instalimit	Tarifat e pajtimit telefonik	Tarifa për një impuls
	pa TVSH (lekë)	pa TVSH (lekë)	(lekë/impuls)
Abonentë familjarë	14,000	200	1.0
Abonentë të tjerë	14,000	800	1.5

### Aktiviteti i Albtelecom Tirana

Emërtimi	Njësia matëse	Viti 2006
Biseda telefonike	000 imp	1,663,150
Biseda me ndërmjetësinë e çentralit	min	6,500
Kanale telef + qarqet në dispozicion	nr	200
Pajtimtarë telefonik	nr	90,831
Aparate me kartë	nr	351
Instalime telefonike	nr	4,428
Transmetime telefonike	nr	995
Rilidhje telefoni	nr	596

*Burimi: INSTAT*

### Shërbimi telegrafik

Emërtimi	Njësia matëse	Viti 2006
Telegrame gjithsej	000/fjalë	488
Kombëtare	000/fjalë	470
Ndërkombëtare	000/fjalë	18

*Burimi: INSTAT*

## Shërbimi postar

Në rrethin e Tiranës kryejnë shërbim postar, financiar dhe shërbimin e biznesit 55 zyra postare. Gjatë vitit 2006 përveç shërbimeve tradicionale kanë hyrë dhe shërbime të reja si: arkëtimi i faturave të KESH-it, arkëtimi i gjobave të Policisë, legalizim i dokumentave të Ministrisë së Jashtme, shërbim Tirana-Ekspres (24 orë), arkëtimi i taksës së studentëve etj.

### Aktiviteti i shërbimit postar

Viti 2006

Emërtimi	Njësia matëse	Gjithsej	Publike
Zyra postare	numër	55	55
Sportelet	numër	109	109
Objekte postare të pranuar (letra, mall etj.)	mijë copë	3,218	219
Shërbime financiare të ofruara-lloje	numër	17	10
Shërbime financiare- arkëtime	mijë copë	2,415	1,273
Shërbime financiare- pagesa	mijë copë	1,202	1

*Burimi: INSTAT*

### Aktiviteti i shërbimit të telefonisë fikse

Emërtimi	Viti 2006
Pajtimtarë familjarë	46,532
Pajtimtarë të tjerë nga këto:	6,826
telekomi	229
aparate me kartë	229
<b>Numra të lidhur me çentralet telefonik gjithsej</b>	<b>53,358</b>

Burimi: INSTAT

## Turizmi

Sipas **Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit** deri në Mars të vitit 2007 në Tiranë janë 64 subjekte të licënuara për ushtrim veprimtarie turistike si agjenci turistike udhëtimi dhe 18 njësi akomoduese turistike të licënuara. Tabela e mëposhtme jep të dhëna mbi klasifikimin e njësisve akomoduese turistike të licënuara.

Emërtimi	Numër	Dhoma	Shtretër
Hotele me 1 yll	2	38	72
Hotele me 2 yje	2	37	51
Hotele me 3 yje	6	129	212
Hotele me 4 yje	4	364	706
Hotele me 5 yje	1	151	302
Hotele të tjera	3	100	193

Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Disa nga pikat turistike që mund të vizitohen në Tiranë janë:

- Mozaiku i Kishës Paleokristiane
- Kompleksi muzeal i Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe Sheshit “Skënderbej”
- Parlamenti (Teatri i Kukullave)
- Xhamia e Et’hem Beut
- Kulla e Sahatit e ndërtuar në vitin 1830.
- Varri monumental i Kapllan Pashës
- Kalaja e Tiranës
- Rezidenca Mbretërore
- Kompleksi monumental i Sheshit të Flamurit
- Lulishtja publike më e vjetër e qytetit
- Shatërvani i parë i qytetit
- Ura e Tabakëve
- Vendi ku është shpallur Pavarësia
- Rrapi monumental i Tabakëve
- Varrezat e Dëshmorëve si pikë turistike dhe monument artistik.

- Pallati i Brigadave
- Kalaja e Petrelës

## SHËRBIMET PUBLIKE

### Pastrimi

Në qytetin e Tiranës transportohen mesatarisht rreth 850-900 ton mbeturina në ditë ose 0.8 kg/banor/ditë, mbetje të ngurta.

Aktualisht, mbulohet me shërbim të plotë pastrimi e gjithë sipërfaqja urbane e qytetit. Rreth 78% e saj mbulohet nga 3 kompanitë private të pastrimit kurse 22% nga Ndërmarrja e Kuartallave.

Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane kryhet çdo ditë në të gjitha pikat kurse në zonat me dendësi tregtare dhe urbane 2 herë në ditë.

Gjatë viteve 2001-2006, janë kryer investime të cilat kanë përmirësuar administrimin e mbetjeve në fushën e Sharrës si:


- Blerja e Buldozierit Tip Caterpillar.
- Riparimi i rrugës hyrëse kryesore me gjatësi mbi 1 km, hapja e pjacaleve (brenda fushës) për depozitimin e mbeturinave si dhe mirëmbajtja e rrugëve brenda fushës.
- Shtimi e një sipërfaqeje të re për depozitim në fusha prej 320 m<sup>2</sup>
- Rehabilitimi i fushës së përpunimit të mbeturinave Sharrë duke realizuar shtrimin e rrugës hyrëse kryesore, shtrimin e 3 rrugëve hyrëse në fushat e reja të depozitimit dhe ndërtimin e kanaleve anësore.
- Rehabilitimi i dy fushave ekzistuese dhe rrugëve hyrëse në to, ndërtimi i dy fushave të reja, ndërtimi i shtresave rrugore, asfaltimi i rrugës kryesore, ndërtimi rrethit të ndriçimit, vendosja e portave dhe tombinot e kanalit.

Disa të dhëna të përmbledhura për shërbimin e pastrimit në qytetin e Tiranës jepen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

**Të dhëna mbi shërbimin e pastrimit në vite**

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006
1	Sasia ditore e largimit të mbeturinave	ton/ditë	455	378	484	536	637	919
2	Sipërfaqja urbane që lahet (rrugë)	m <sup>2</sup> /ditë	540,000	640,000	640,000	646,400	860,000	860,000
3	Sipërfaqja urbane që fshihet (rrugë)	m <sup>2</sup> /ditë	1,540,000	1,610,000	1,610,000	1,620,000	1,700,000	1,700,000
4	Sipërfaqja e fushës së depozitimit	ha	5	5	5	5	5	5
5	Kontenierë mbeturinash ekzistues	copë	2,230	2,300	2,200	2,300	2,300	2,838
6	Mbeturina të transportuara në fushën e Sharrës	ton	298,074	208,665	273,110	318,593	309,920	553,585

### Mbeturina të transportuara në fushën e Sharrës në vite



Ndër projektet e realizuara nga Drejtoria e Pastrimit gjatë viteve 2001-2006 përmendim:

- “Blerja e rreth 2,500 koshave rrugorë” – financim i Ambasadës Angleze, Shoqatës së Ndërtuesve, Vodafone, ICMA
- Fushata sensibilizuese në bashkëpunim me komunitetin dhe studentë vullnetarë në Ditët Botërore Mjedisore
- “Disiplinimi i hedhjes së mbetjeve të ngurta voluminoze në 18 rrugë tregtare”
- “Pastrimi vullnetar i ambienteve publike” - bashkëpunim me shoqatën PASS me pjesëmarrje të vullnetarëve dhe studentëve
- “Vendosja e Sinjalistikës Vertikale – Impakt pozitiv në përmirësimin e cilësisë së ajrit të qytetit”
- “Ndarja dhe riciklimi i mbetjeve në Bashkinë e Tiranës, hartimi dhe miratimi i Udhëzuesve Mjedisorë për ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta”
- “Përforsimi i ligjit mbi parandalimin e ndotjes së mjedisit në nivel lokal” - financim i OSBE
- Studimi i fizibilitetit për projektin "Për një komunitet ndryshe një bllok banimi ndryshe" për Bllokun e Televizionit – bashkëpunim me Cataëba dhe ICMA
- Zbatimi i "Udhëzuesit mjedisor për Bashkinë e Tiranës" – financim i Firmës ricikluese “Hermes”
- Projekti "Administrimi i mbetjeve të ngurta në Institucionet Arsimore në qytetin e Tiranës" – financim i OSBE dhe bashkëpunim me Qendrën “Eden” e studentë vullnetarë
- Përfundimi i rregullores mbi "Administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit"
- Hartimi i “Strategjisë Lokale të Mjedisit 2005-2008” - bashkëpunim me Qendrën “Eden”

## Infrastruktura

Në periudhën 2001-2006, në fushën e infrastrukturës nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike janë realizuar rreth:

- 1 milion m<sup>2</sup> rrugë të reja e të rikonstruktura
- 350 mijë m<sup>2</sup> trotuare të reja e të rikonstruktura
- 15 blloqe banimi (3 në qendër dhe 12 në periferi)

- 141 mijë ml rrjet i ri ujësjellësi
- 77 mijë ml rrjet i ri kanalizimi
- 10,970 ndriçues publik në të gjitha rrugët e ndërtuara dhe rikonstruktura

Gjatë vitit 2006, nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike në infrastrukturën rrugore janë kryer punime nga të ardhurat e Bashkisë për rikonstruksionin e 27 objekteve nga të cilat:

- 11 objekte të reja
- 16 objekte në vazhdim

Investimet e Bashkisë së Tiranës në institucionet arsimore parauniversitare kanë filluar në vitin 2004. Gjatë periudhës 2004-2006 janë realizuar:

- 16 shkolla të rikonstruktura me sipërfaqe rreth 28 mijë m<sup>2</sup> (nga ku 8 mijë m<sup>2</sup> janë sipërfaqe e re)
- 2,700 m<sup>2</sup> laboratore
- 7,500 m<sup>2</sup> palestra e terrene sportive
- 13 kopshte të rikonstruktura

Investimet e realizuara nga të ardhurat lokale për vitit 2006 arrin në 1,657,051 mijë lekë, nga të cilat:


- 1,450,149.5 mijë lekë në infrastrukturën rrugore
- 206,901.5 mijë lekë në infrastrukturën arsimore

Realizimi i investimeve në infrastrukturën arsimore nga Buxheti i Shtetit arrin në 44,386.8 mijë lekë.

#### Realizimi i investimeve në infrastrukturë në vite

000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2000	Viti 2001	Viti 2002	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006
1	Buxheti i Shtetit	303,633	918,775	259,455	155,940	604,704.1	479,065.4	1,657,051.0
2	Të ardhurat lokale	119,236	237,423	408,654	906,845	1,851,951	2,587,352.8	44,386.8
	<b>Gjithsej</b>	<b>422,869</b>	<b>1,156,198</b>	<b>668,109</b>	<b>1,062,784</b>	<b>2,456,654.8</b>	<b>3,066,418.2</b>	<b>1,701,437.8</b>





Projektet e realizuara në vitin 2006 nga **Drejtoria e Projekteve të Infrastrukturës** janë si më poshtë:

1. Unaza e Madhe		L=2,115 ml
2. Rruga A.Z.Çajupi	$S_{rr}=3,310 \text{ m}^2$	$S_{trot}=3,080 \text{ m}^2$
3. Varrezat Tufinë (1)		$S_{sist}=29,900 \text{ m}^2$
4. Varrezat Tufinë (2)		$S_{sist}=5,000 \text{ m}^2$
5. Lulishte		

Sipërfaqe e sistemuar totale dhe sipërfaqe e gjelbër:

Blloku “50 Vjetori”	$S_t=12,158 \text{ m}^2$	$S_{gj}=11,324 \text{ m}^2$
Blloku “Kodra e Priftit”	$S_t=8,167 \text{ m}^2$	$S_{gj}=8,167 \text{ m}^2$
Blloku “Qemal Stafa”	$S_t=2,767 \text{ m}^2$	$S_{gj}=2,767 \text{ m}^2$
Blloku “Mine Peza”	$S_t=26,974 \text{ m}^2$	$S_{gj}=26,407 \text{ m}^2$
Blloku “1 Maji”	$S_t=2,732 \text{ m}^2$	$S_{gj}=2,413 \text{ m}^2$
Vasil Shanto	$S_t=2,000 \text{ m}^2$	$S_{gj}=1,640 \text{ m}^2$
Vaso Pasha	$S_t=28 \text{ m}^2$	$S_{gj}=28 \text{ m}^2$
Shyqyri Ishmi	$S_t=330 \text{ m}^2$	$S_{gj}=250 \text{ m}^2$
Irfan Tomini	$S_t=1,361 \text{ m}^2$	$S_{gj}=1,361 \text{ m}^2$
Abdyl Frashëri	$S_t=211 \text{ m}^2$	$S_{gj}=177 \text{ m}^2$
Pjetër Bogdani	$S_t=350 \text{ m}^2$	$S_{gj}=250 \text{ m}^2$

6. Sistemim dhe asfaltimi i rrugëve

Rr e Elbasanit	L=2,200 ml	$S_{trot}=15,400 \text{ m}^2$
Rr Luigj Gurakuqi	L=470 ml	$S_{trot}=7,990 \text{ m}^2$
Rr e Barrikadave	L=463 ml	$S_{trot}=7,142 \text{ m}^2$
Sheshi Avni Rustemi		$S=4,565 \text{ m}^2$
Rr e Dibrës		$S=14,320 \text{ m}^2$
Rr Mine Peza	L=520 ml	$S_{trot}=4,160 \text{ m}^2$
Rr e Kavajës		$S_{rr}=17,101 \text{ m}^2$

7. Rikonstruksioni i trotuareve të rrugëve:

Rr Luigj Gurakuqi	L=850 ml	$S=6,214 \text{ m}^2$
Rr e Barrikadave		$S=5,013 \text{ m}^2$
Sheshi Avni Rustemi		$S=800 \text{ m}^2$
Rr e Kavajës	L=2,029 ml	$S=8,116 \text{ m}^2$
Bul Zhan D’Ark dhe Bajram Curri	L=326 ml	$S=1,430 \text{ m}^2$
Pallati i Kulturës	L=250 ml	$S=2,216 \text{ m}^2$

Gjatë periudhës 2001-2006, **donatorë të huaj** si FSHZH, Kooperacioni Italian, Banka Botërore, IOM, UNDP dhe UEFA kanë financuar investimet në infrastrukturë konkretisht:

Rikonstruksion rruge	1,076,742.783 mijë lekë
Ndriçim	137,925.652 mijë lekë

Lulishte	199,907.243 mijë lekë
Kanalizime	292,205.280 mijë lekë
Fasada	187,099.663 mijë lekë
Mjedise sportive	195,000 mijë lekë
Projekte	31,238 mijë lekë
Ndërhyrje në fushën e plehrave Sharrë	22,800 mijë lekë
Të tjera	4,313.1 mijë lekë

Investimet e realizuara gjatë periudhës 2001-2006 nga **Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Qytetit** në hapësirat e gjelbërta kanë konsistuar në:

- ndërtimin e lulishteve të reja;
- krjimin e lulishteve apo hapësirave të gjelbërta në mjediset e lira brenda blloqeve të banimit;
- mbjellje drurësh e shkurresh dekorative përgjatë rrugëve të rikonstruara;

Konkretisht, është punuar për shtimin e 47 parqeve e lulishteve të reja me:

- 192,913 m<sup>2</sup> sipërfaqe totale
- 163,501 m<sup>2</sup> sipërfaqe e gjelbërt
- 999 drurë
- 4,706 shkurre
- 915 m<sup>2</sup> sipërfaqe e mbjellë me lule

Është punuar për rikonstrukcionin e pjesshëm të hapësirave të gjelbërta ekzistuese me:

- 119,773 m<sup>2</sup> sipërfaqe e gjelbërt
- 4,715 drurë
- 3,767 shkurre
- 1,963,005 copë lule

Gjithashtu, është realizuar gjelbërimi i 42 rrugëve të reja me gjatësi 18,690 ml ku janë mbjellë 4,966 drurë, 4,027 shkurre.

Gjatë viteve 2002-2006, kjo Drejtori ka kryer punime në Lanë në segmentet e mëposhtme:

- Seg. Rr e Elbasanit-Katedralja
- Seg. Bul "Dëshmorët e Kombit"- Rr."Dëshmorët e 4 Shkurtit"
- Seg. Ura "Ali Demi"- Ura e Elbasanit
- Seg ATSH-Brryli
- Seg. Rr."Dëshmorët e 4 Shkurtit"-Rr "Sami Frashëri"
- Seg. Rr "Sami Frashëri"- Rr."Vasil Shanto"
- Seg. Brryli-Matërniteti i Ri
- Seg. Rr."Vasil Shanto"- Rr "Irfan Tomini"
- Seg. Rr "Irfan Tomini" - Shkolla Teknologjike (Bul"Zhan D'Ark")
- Seg. Rr "Irfan Tomini" – Shkolla Teknologjike (Bul" Bajram Curri")

Pra, janë kryer punime në një sipërfaqe prej 99,736 m<sup>2</sup> e gjatësi prej 4,545 ml ku janë vendosur:

- 666 drurë

- 1,598 shkurre
- 5,000 copë lule
- 214 stola
- 193 kosha.

**Drejtoria Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit** merret me mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve dhe rrjetit të ujrave të bardha. Gjatë vitit 2006, është kryer:

- Asfaltimi i 83 objekteve me një sipërfaqe totale prej 84,470 m<sup>2</sup>;
- Shtrimi me pllaka bituminoze në një sipërfaqe prej 3,869 m<sup>2</sup>;
- Shtrimi me pllaka trotuari në një sipërfaqe prej 4,553 m<sup>2</sup>;
- Pastrim zgarash në 8,593 copë;

#### Punime të kryera

			<i>Viti 2006</i>
Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Riparim dhe shtrim me asfalt beton	m <sup>2</sup>	84,470
2	Shtrim me pllaka bituminoze	m <sup>2</sup>	3,869
3	Shtrim e riparim pllaka çimento	m <sup>2</sup>	4,492
4	Vendosje kapakë zgarash	copë	418
5	Rikonstrukcion kanalesh zgarash me tuba	ml	648
6	Bërje pusetash zgarash të reja	copë	17
7	Vendosje kapakë 1x1m; 0.7x0.7m	copë	88
8	Betonime	m <sup>3</sup>	384
9	Vendosje bordura të reja	ml	4,239
10	Riparime me guraleca	m <sup>2</sup>	61
11	Riparim zgara ekzistuese	copë	73
12	Shtrim me stabilizant	m <sup>3</sup>	1,895
13	Skarifikim për asfaltime	m <sup>2</sup>	76,505
14	Pastrim dhe zhbllokim zgarash	copë	8,593
15	Pastrime dhe riparime kunete	ml	86
16	Vendosje kapakë betoni	copë	119
17	Ndërtim kontenierësh	copë	24
18	Riparim bordurash ekzistuese	ml	554
19	Ndërtim mur tulle	m <sup>3</sup>	8
20	Punime të kryera me hekur	kg	128

**Drejtoria Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit** kryen punime mirëmbajtjeje të planifikuara dhe emergjente si punime hidraulike e elektrike, punime marangozi, ndërhyrje në nyje sanitare si dhe lyerje të ambjenteve të jashtme e të brendshme të objekteve shkollore dhe parashkollore nga të cilat:

- 14 shkolla të mesme të përgjithshme
- 52 shkolla 9–vjeçare
- 44 kopshte
- 29 çerdhe

Gjatë vitit 2006, nga kjo drejtori është ndërhyrë për mirëmbajtjen e 54 objekteve shkollore. Konkretisht, është kryer:

- 127,590 m<sup>2</sup> lyerje totale

- 24,618 m<sup>2</sup> lyerje të jashtme
- 102,972 m<sup>2</sup> lyerje të brendshme
- 1,220 m<sup>2</sup> riparim dhe hidroizolim tarrace
- 800 m<sup>2</sup> suvatime
- 30 m<sup>2</sup> dritare
- 110 m<sup>2</sup> dyer druri dhe duralumini
- 950 m<sup>2</sup> xhama dhe 30 m<sup>2</sup> xham akulli

## Shërbimi Funeral

Shërbimi funeral në Tiranë kryhet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale Tiranë e cila është shoqëri shtetërore me aktivitet kryesor mirëmbajtjen dhe shërbimin në varreza dhe 25 subjekte private (persona fizikë dhe sh.p.k) të cilat kryejnë shërbimin mortor kryesisht jashtë varrezave. Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale Tiranë ka nën juridiksionin e saj varrezat e Sharrës dhe Tufinës me një sipërfaqe totale prej 493,873 m<sup>2</sup>. Në fund të vitit 2006 janë shtuar për nevoja emergjente (mungesë sipërfaqe varrimi) rreth 5,000 m<sup>2</sup> sipërfaqe e shpronësuar. Gjatë vitit 2006, janë kryer 140 varrime nga Ndërmarrja e Shërbimeve Funerale dhe 2,677 varrime nga shoqëritë private.

Një listë e subjekteve private që operojnë në fushën e shërbimeve funerale jepet si më poshtë:

Funeral Alba 2000  
 Funeral Mani  
 Funeral Luli 2000  
 Funeral Perla  
 Funeral Parajsa  
 Funeral Skadi  
 Funeral Dhima  
 Funeral Arba  
 Funeral Ladi  
 Funeral Sallai  
 Funeral Buda  
 Funeral Dea  
 Funeral Tibos

Funeral Shpresa  
 Funeral Qordja  
 Funeral Paqja  
 Funeral Ernesti  
 Funeral Tirana 1  
 Funeral Bebri  
 Funeral Edba  
 Funeral Kuka  
 Funeral Arbër Dede  
 Funeral Lamtumira  
 Funeral Beqaj  
 Funeral Sokoli

## URBANISTIKA

Gjatë vitit 2006, janë punuar nga **Drejtoria e Planit Rregullues** dhe janë paraqitur nga Studio Projektimi të liçensuara 228 studime urbanistike gjithsej, prej të cilave janë të miratuara 54 studime (45 studime urbanistike pjesore nga të cilat 5 janë rivlerësime studimesh urbanistike pjesore dhe 9 kërkesa për ndryshim destinacioni). Pjesa tjetër e përbërë prej 174 studime (studime pjesore dhe ndryshime destinacioni) është ende në proces. Studimet urbanistike të miratuara deri në fund të vitit 2006 përbëjnë mbulojnë në total një sipërfaqe prej 1,027 ha ose 23.34% të sipërfaqes komplekse të Tiranës.

Studimet urbanistike të miratuara gjatë vitit 2006 paraqiten si më poshtë vijon:

### **Studime urbanistike pjesore:**

- Studim urbanistik në Rr. "Sulejman Delvina"
- Studim urbanistik në Laprakë, kufizuar nga Rr.e Durrësit, Rr. "L. Bajron" dhe Rr. "Gj.Legisi".
- Studim urbanistik në Rr. e Elbasanit, kufizuar nga Rr.e Elbasanit, Rr. "A. Broci" dhe Rr. "Unaza e Re"
- Studim urbanistik midis Rr. "Q.Stafa", "D. Hekali", "A. P. Gucia" dhe "R. Cerova"
- Studim urbanistik tek Selvia, kufizuar nga Rr. "4 Dëshmorët", "Q.Stafa", "Sh.Dishnica", "Ali Pashë Gucia"
- Studim urbanistik në Rr. "Frosina Plaku", kufizuar nga Rr."M. Gjollësia", "F. Plaku", "N. Mjeda", "Kongresi i Lushnjës"
- Studim urbanistik tek ish-Blloku, kufizuar nga Rr. "Bajram Curri", Rr. "Sami Frashëri" dhe Rr. "Vaso Pasha".
- Studim urbanistik i kufizuar nga Rr. "4 Dëshmorët", Rr. e Dibrës dhe Rr. "A. P.Gucia"
- Studim urbanistik i kufizuar nga Rr. "Q. Stafa", Rr. "S. Kodra", Rr. e Barrikadave dhe Rr. "F. Xhajko"
- Studim urbanistik i kufizuar nga Rr. "A. Spahia", Rr. "H. Tahsin", Rr. "Q. Stafa" dhe Rr. "Faik Trenova"
- Studim urbanistik në Selitë, kufizuar nga Rr. e Planit Rregullues dhe Rr. "I. Tomini"
- Studim urbanistik në Rr. "M. Shyri", Rr. "M. Gjollësia", Rr. e Kavajës, Rr. "N. Lena" dhe Rr. "S. Kruja".
- Studim urbanistik tek "Ish N.P.V. -ja".
- Studim urbanistik në Rr. "B. Konxholli", kufizuar nga Rr. "B. Konxholli" dhe Rr. "Sh. Oshafi".
- Studim urbanistik kufizuar nga Rr. e Durrësit, "Unaza e Re", "Lana" dhe në lindje me kompleksin "Izraelit".
- Studim urbanistik kufizuar nga Rr. e Kavajës, "Unaza e Re" dhe "Lana".
- Studim urbanistik tek Rr. "Jordan Misja".
- Studime urbanistik në Blv. "Gjergj Fishta" (pranë ekspozitës "Shqipëria sot")
- Studim urbanistik në Rr. "Don Bosko", kufizuar nga Rr. "M. Gjollësia", Rr. në projekt, dhe Rr. Unaza e Re në projekt.
- Studim urbanistik në Rr. "Budi", kufizuar nga Rr. "N. Pavllo", Rr. "P. Budi", Rr. "Q. Guranjaku".
- Studim urbanistik kufizuar nga "Rr. e Durrësit" dhe Rr. "M. Peza".
- Studim urbanistik në Rr. "S. Bega", kufizuar nga Rr. "R. Cerova", Rr. "Dervish Hekali", Rr. "Sul Bega".
- Studim urbanistik në Laprakë (1), GINTASH.
- Studim urbanistik në Laprakë (2), VEFA.
- Studim urbanistik kufizuar nga "Lana" dhe Rr. e Kavajës.
- Studim urbanistik tek ish fusha e aviacionit civil, Izraelit.
- Studim urbanistik në Rr. "S. Frashëri".
- Studim urbanistik në Rr. "M. Shyri"
- Studim urbanistik në Rr. "H. Dalliu"
- Studim urbanistik tek Tregu Elektrik, kufizuar nga Rr. "P. N. Luarasi" dhe Rrugë e Planit Rregullues.
- Studim urbanistik në Rr. e Kavajës, kufizuar nga Rr. e Kavajës, Bul. "Zhan D'Ark" dhe "Irfan Tomini".

- Studim urbanistik në Rr. “I. Tomini”, kufizuar nga Rr. “I Tomini”, dhe Rrugë e Planit Rregullues.
- Studim urbanistik në Rr. “Jordan Misja”
- Studim urbanistik në Rr. "I. Dollaku".
- Studim urbanistik i Qendrës së Qytetit të Tiranës
- Studim urbanistik në Rr. “I. Tomini”.
- Studim urbanistik në Rr. e Durrësit
- Studim urbanistik në Rr. e Kavajës përballë Kombinatit “Misto Mame”
- Studim urbanistik në Rr. “Qemal Stafa”
- Studim urbanistik në Rr. “Komuna e Parisit”
- Studim urbanistik në Selitë
- Studim urbanistik në Rr. “Hoxha Tahsin” dhe Rr. “Jani Vreto”
- Studim urbanistik në Rr. “Komuna e Parisit”
- Studim urbanistik në Rr. “Anastas Kullurioti”
- Studim urbanistik në Rr. ‘Ali Visha’
- Studim urbanistik në Rr. “Arkitekt Kasemi”
- Studim urbanistik në Rr. “Don Bosko
- Studim urbanistik në Rr. “Margarita Tutulani
- Studim urbanistik kufizuar nga Lana dhe Rrugë e Planit Rregullues
- Studim urbanistik në Rr. “Sadik Petrela”
- Studim urbanistik në Rr. “Qemal Stafa”
- Studim urbanistik në Rr. e Dibrës
- Studim urbanistik në Rr. “Nikolla Lena”
- Studim urbanistik në Rr. “Jordan Misja”
- Studim urbanistik në Rr. “Niko Avrami”
- Studim urbanistik në Rr. “3 Vellezerit Kondi”
- Studim urbanistik në Rr. “Fadil Rada”
- Studim urbanistik në Rr. “Irfan Tomini”
- Studim urbanistik në Rr. “Q. Stafa”, “H. Tahsim”
- Studim urbanistik në Bul. “Zhan D’Ark”
- Studim urbanistik në Rr. “Don Bosko”
- Studim urbanistik në Rr. e Dibrës
- Studim urbanistik në Rr. “Ali Demi” (Shemsi Haka)
- Studim urbanistik në Rr. “Stavri Themeli”
- Studim urbanistik në Rr. “Ali Demi (Shemsi Haka) BJORN
- Studim urbanistik në Rr. e Kavajës
- Studim urbanistik në Rr. “Kongresi i Manastirit
- Studim urbanistik në Rr. “5 Maji” (Myderizi)
- Studim urbanistik në Rr. e Kavajës Kombinat (Kisha)
- Studim urbanistik në Rr. “Selaudin Zorba” (Hallias)
- Studim urbanistik në Rr. “Kongresi i Manastirit” Zona 4
- Studim urbanistik në Rr. “Don Bosko (Sfera)”
- Studim urbanistik në Rr. “Don Bosko”
- Studim urbanistik në Rr. “Don Bosko”, “Rr. Vjetër e Shkodrës”
- Studim urbanistik në Rr. “Durrësit”, “Don Bosko”
- Studim urbanistik në Rr. “Dibrës”, “Njazi Meka”
- Studim urbanistik në Rr. “Niko Avrami”, “Njazi Meka”

- Studim urbanistik në Rr. e Dibrës, “Niko Avrami”
- Studim urbanistik në Rr. “Mine Peza (Unaza)”
- Studim urbanistik në Rr. “Hoxha Tahsim”, “Beqir Luga”
- Studim urbanistik në Rr. “Vellezërit Manastirli”, “Naim Frashëri”
- Studim urbanistik në Rr. “në Rr. “Q. Stafa”, “B. Curri”
- Studim urbanistik në Rr. “R. Cerova”
- Studim urbanistik në Rr. “S. Nivica”
- Studim urbanistik në Rr. “5 Maji”
- Studim urbanistik në Rr. “Z. Curre”, “P.N.Luarasi”, “T. Shkurti”, “M. Grameno”
- Studim urbanistik në Rr. e Durrësit
- Studim urbanistik në Rr. “Don Bosko, Rr. Vjetër e Shkodrës, veri zonë shkolle dhe universiteti
- Studim urbanistik në Rr. e Kavajës, Rr. “Bogdanëve”, Rr. “Gjon Muzaka”, Rr. “Edit Durham”
- Studim urbanistik në Rr. “H.H. Dalliu”
- Studim urbanistik në Rr. e Kavajës, Rr. “Irfan Tomini”
- Studim urbanistik në Rr. “Qemal Stafa”
- Studim urbanistik në Rr. “Komuna e Parisit dhe Rr. e KESH-it

#### **Studime urbanistike me kritere:**

- Studim urbanistik në Rr. “R. Farka”, kufizuar nga Rr. e Dibrës", Rr. “Bardhyl”, Rr. “R. Cerova”, dhe Rr. “D. Gashi”.
- Studim urbanistik në Rr. “M. Grameno”, kufizuar nga Rr. “M. Grameno”, Plani i Qendrës dhe me zonë informale.
- Studim urbanistik në Rr. “M. Shyri”, Rr. “R. Çollaku”, Rr. “Çamëria” dhe Rr. “M. Ulqinaku”.
- Studim urbanistik ne segmentin nga Rr. “M. Shyri” deri në Rr. e Kavajës. (Rr. “Sami Frashëri”)
- Studim urbanistik në Rr. “Ali Demi”, kufizuar nga Rr. "M. Grameno" dhe Rr. "B. Curri”.
- Studim urbanistik në “Hallias”, kufizuar Rr. Unaza e Re, Rr. e Dibrës, Rr. "M. Keta”, Rr. “F. Xhajko”, Rr. “5 Maji”.
- Studim në Rr. “Skënderbej”, kufizuar nga Rr. “Skënderbej” dhe Rr. "N. Frashëri".
- Studim tek Rr. e Durrësit.

#### **Rrjete rrugore:**

- Studim i rrjetit rrugor në Njësinë Bashkiake Nr. 8, kufizuar nga Rr. "S. Kodra", Rr. "F. Xhajko, Rr. "5 Maji” dhe Rr. Unaza e Re.
- Studim urbanistik në Rr. “Kongresi i Manastirit”

Drejtoria e Planit Rregullues gjatë vitit 2006 ka marrë pjesë në këto konkurse :

#### ***“European Prize for Urban Public Space”, Barcelona 2006***

Çmimi Evropian për Hapësirat Publike Urbane është konkurs bienal, i cili ka për qëllim të njohë dhe të inkurajojë aktivitetet e ndërhuara për të krijuar pika tërheqjeje në qytet. Ky çmim u

jepet si autorëve të projektit ashtu edhe institucioneve të cilat janë iniciatore të rimodelimit të hapësirave publike, me qëllim përmirësimin e jetës urbane.

Në konkurs u paraqitën projektet për rehabilitimin e hapësirave publike: Lana dhe Parku Rinia, si edhe projekti për rehabilitimin e fasadave të pallateve, respektivisht: “Clean & Green” dhe “Colourful Tirana”.

#### **“Livable Community Awards”, Hangzhou-China, 2006**

LivCom është i vetmi në botë përsa i përket Konkurseve të Çmimeve të fokusuar në praktikat më të mira për menaxhimin e mjediseve lokale. Çmimet LivCom janë i vetmi forum ku Praktikrat më të Mira Ndërkombëtare mund të shquhen dhe zhvillohen. Gjithashtu, pjesëmarrja në Çmimet LivCom është një investim për të ardhmen e komunitetit.

Çmimet për Praktikrat më të Mira jepen në bazë të kategorive të përcaktuara në referencë me popullsinë e qyteteve apo komuniteteve. Tirana konkuroi në kategorinë D për një popullsi 200,000 deri 750,000 banorë.

**Praktika e Bashkisë së Tiranës në këto 6 vitet e fundit u vlerësua nga juria ndërkombëtare me çmimin e argjendtë.**

Nga kjo Drejtori është publikuar *botimi “Tirana, Arkitekturë dhe Konkurse”*

Bashkia e Tiranës, vitet e fundit ka organizuar disa konkurse ndërkombëtare, të cilat mundësuan sjelljen e arkitektëve me përvojë e famë ndërkombëtare në Shqipëri. Kontaktet direkte me ta, pjesëmarrja në juritë dhe diskutimet rreth projekteve ishin një eksperiencë e panjohur më parë.

Konkursi për qendrën dhe disa objekte kryesore në të, si edhe projekti për dy parqet kryesore të qytetit, përbëjnë elementët e këtij botimi.


Qëllimi i këtij botimi është prezantimi me idetë inovative dhe vizionin për qytetin e Tiranës.

Gjatë periudhës 2001-2006, K.RR.T-ja e Bashkisë së Tiranës ka dhënë 756 leje ndërtimi gjithsej. Tabelat dhe grafiku i mëposhtëm japin të dhënat në vite në mënyrë më të detajuar:

**Të dhëna nga K. RR. T.**

Viti	Sheshe ndërtimi	Leje ndërtimi	Të ndryshme	Studime urbanistike	Infrastrukturë	Legalizime	Vendime njoftime
2001	66	114	66	14	17	13	79
2002	131	131	43	34	34	11	97
2003	117	130	45	13	23	12	15
2004	82	141	51	25	77	6	49
2005	116	144	53	45	19	11	37
2006	56	96	9	50	22	0	23
<b>Gjithsej</b>	<b>568</b>	<b>756</b>	<b>267</b>	<b>181</b>	<b>192</b>	<b>53</b>	<b>300</b>





Gjatë vitit 2006, KRRT e Bashkisë së Tiranës ka zbardhur gjithsej 71 leje për ndërtesa. Gjithashtu, është miratuar ndërtimi i 2,981 apartamenteve të reja. Të dhëna më të detajuara paraqet tabela dhe grafiku i mëposhtëm:

**Tregues të objekteve të ndërtimit, sipas lejeve të siguruara, sipas tipeve të objekteve**

Emërtimi	Nr.	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Fondi i parashikuar në 000/ lekë	
			Objekte të reja	Rikon.+shtesa
Viti 2001	67	219,652.2	5,415,850.9	238,528.4
Viti 2002	129	406,553.2	11,385,777.2	281,923.6
Viti 2003	155	847,393.2	25,378,946.2	190,612.8
Viti 2004	108	632,355.9	18,333,856.8	76,192.9
Viti 2005	139	834,562.0	24,195,723.5	100,435.7
Viti 2006	71	565,076.0	16,939,190.9	83,489.1

## MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Bashkia e Tiranës është në kontakt të përditshëm me qytetarët e saj. Gjatë vitit 2006 në Sektorin e Informimit Qytetar kanë ardhur 68,596 qytetarë (ose 277 qytetarë në ditë) nga të cilët 22,790 kanë aplikuar me shkrim kërkesa apo ankesa. Statistikat e Zyrës së Informimit Qytetar në vite paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	Qytetarë të ardhur	Kërkesa/Ankesa	Përgjigje të kthyera
2001		3,601	789
2002		3,596	1,013
2003		17,740	15,256
2004	63,449	21,784	21,421
2005	73,329	21,199	20,578
2006	68,596	22,790	22,330

Gjithashtu, gjatë vitit 2006 janë kryer 165 celebrime, janë dhënë 9,397 çertifikata me pullë dhe janë bërë 547 njoftime dhe verifikime si dhe janë pranuar 569 çertifikata për jashtë shtetit, të cilat janë tërhequr të gjitha nga kërkuesit.

Në Sektorin e Informimit Qytetar herë pas here zhvillohen sondazhe, nëpërmjet të cilëve merren mendimet e qytetarëve mbi shërbimet që ofron Bashkia, mbi nevojat që kanë, ku mendojnë se duhet të vazhdojë investimet Bashkia, etj. Këto të dhëna përpunohen nga Sektori i Statistikave dhe rezultatet u jepen Kryetarit, Nënkryetarëve, Kabinetit, Drejtorëve të Përgjithshëm në mënyrë që t'i kenë parasysh gjatë marrjes së vendimeve të ndryshme.

Që prej Janarit 2005, 7 ditë në javë nga ora 8.00 deri në 22.00, funksionon rregullisht Qendra Operatore e Bashkisë së Tiranës. Kjo qendër ofron ndihmë dhe informacione nëpërmjet telefonit për të gjithë qytetarët, për shqetësimet dhe nevojat e tyre në lidhje me shërbimet që ofron Bashkia e Tiranës. Telefoni **0800 0888** ofrohet falas për të gjitha thirrjet nga i njëjti rrjet.

### ***Buletini Statistikor***

Çdo vit, Bashkia e Tiranës publikon të dhënat e punës së saj. Duke parë interesin e qytetarëve, institucioneve shqiptare, institucioneve të huaja, bizneseve, etj. është parë e arësyeshme të shtohet gama e informacioneve që publikohet.

Kështu, është rritur sasia dhe lloji i informacioneve të publikuara nga vetë Bashkia e Tiranës, por gjithashtu janë publikuar të dhëna dhe nga institucione të tjera, të cilat janë vlerësuar me interes për publikun e gjerë.

Që prej 3 vitesh janë publikuar të dhënat në vite, gjë kjo e cila ka ndihmuar çdo lexues të kuptojë ndryshimin e treguesve nga viti në vit. Ky publikim i rëndësishëm botohet në shqip dhe në anglisht.

Bashkia e Tiranës ka faqen zyrtare të internetit [www.tirana.gov.al](http://www.tirana.gov.al). Në faqen e internetit gjenden informacione të shumta mbi:

- Qytetin
- Shërbimet
- Biznesin
- Urbanistikën
- Projektet
- Bashkinë
- Opinione

Në secilin prej këtyre linqeve, ka informacione të shumta specifike dhe secili qytetar mund të mirëinformohet për çdo gjë. Gjithashtu, në faqen e internetit nxirren njoftimet e ndryshme, Vendimet e Këshillit Bashkiak, lajmet, emisioni i Kryetarit të Bashkisë dhe komunikimi i tij me qytetarët (audio), etj.

### ***Stenda e Publikimeve të Vendimeve dhe njoftimeve të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak***

Ndodhet pranë Bashkisë së Tiranës dhe përditësohet nga Specialistët e Sektorit të Informimit Qytetar. Në këto stenda publikohen:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak
- Vendimet e KRRT-së
- Njoftimet e të gjitha drejtorive
- Njoftimet e punësimit
- Aktivitete
- Etj.

### ***Fushata Publicitare***

Bashkia e Tiranës përdor një sërë mënyrash për të sensibilizuar qytetarët e saj nëpërmjet:

- Spoteve publicitare në televizionet më të ndjekura
- Ekranit në Sektorin e Informimit Qytetar
- Emisioneve radiofonike dhe televizive
- Fletëpalosjeve, etj

### ***Emisione Radiofonike – Televizive***

Bashkia e Tiranës e vlerëson shumë të rëndësishme komunikimin me publikun, me të gjitha mënyrat e mundshme. Duke qenë se shpesh probleme që shqetësojnë qytetarë të caktuar kanë interes edhe për një kategori shumë më të madhe qytetarësh, janë organizuar disa emisione televizive. Në emisione kanë qenë të pranishëm drejtues dhe specialistë të Bashkisë të cilët i janë përgjigjur telefonatave direkte të qytetarëve. P.sh. “Ekрани i Tiranës” në Alba TV, “Zërat e Kryeqytetit” në News 24. Gjithashtu, një emision që vazhdon prej më se 2 vitesh është “Punë të Mbarë” që realizohet nga vetë Kryetari i Bashkisë çdo të hënë në orën 07:00 – 08:00. Në këtë emision qytetarët kanë mundësi të komunikojnë direkt me Kryetarin e Bashkisë dhe t’i transmetojnë shqetësimet e tyre, të diskutojnë për tema të ndryshme, etj.

### ***Transparenca për Bashkinë e Tiranës***

Duke konsideruar rëndësinë që kanë opinionet e qytetarëve për institucionet në shërbim të tyre, për të pestin vit rradhazi u realizua Transparenca për Bashkinë e Tiranës.

Disa prej treguesve të vlerësimit qytetar në lidhje me punën dhe shërbimet kryesore që ofron Bashkia e Tiranës për komunitetin jepen si më poshtë:

- 69% e qytetarëve mendojnë se puna e bërë nga Bashkia për shërbimet sociale është e mirë dhe shumë e mirë.
- 80% e qytetarëve janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me cilësinë e rrugëve në qendër dhe bulevardet kryesore
- 50% e qytetarëve janë shumë të kënaqur dhe të kënaqur me cilësinë e rrugëve në lagjet e tyre.
- 81% e qytetarëve mendojnë se gjendja në trotualet e rikonstruktura nga Bashkia është e kënaqshme.
- 67% e qytetarëve janë të gatshëm të paguajnë më shumë për tarifën e pastrimit
- 67% e qytetarëve e vlerësojnë shumë të mirë dhe të mirë punën e Bashkisë për pastërtinë e qytetit.
- 60% e qytetarëve mendojnë se gjendja me semaforët paraqitet e kënaqshme
- 56 % e qytetarëve janë të kënaqur me cilësinë e parqeve dhe hapësirave të gjelbërta në qytet